



TRADITË&KULTURË



MËSUESI&NXËNËSI



ARSIMI&REFORMA



SHKOLLA&KOMUNITETI

## Nis udhë diskutimi për projektligjin e Arsimit Parauniversitar

### Projektligji për Arsimin Parauniversitar

Nga fjala e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Z. Myqerem Tafaj

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, zoti Myqerem Tafaj, në një konferencë të zgjeruar me drejtues të arsimit në të gjithë vendin, personalitete të botës së arsimit, ish-ministra të arsimit, rektorë, dekanë, profesorë, nxënës të shumë shkollave të kryeqytetit, ka paraqitur projektligjin “për Arsimin Parauniversitar” duke hapur diskutimin publik të tij . Kjo ngjarje e madhe arsimore vjen si një reformë e re, pas vlerësimit të raportit “PISA”, që e rendit Shqipërinë ndër tre vendet me progres më të dukshëm nga 65 vende të vlerësuara. Ky projekt do të jetë ligji i arsimit të standardeve evropiane. Ministri Tafaj tha se ky draft ka një pjesëmarrje të gjerë ekspertize vendase dhe të huaj dhe ne jemi të hapur për ta dëgjuar fjalën e personaliteteve e ekspertëve.

*Shqipëria - Progres të dukshëm në arsim sipas raportit “PISA” të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD 2010)*

*Raporti “PISA 2009” (Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve) ka vlerësuar arritjet e nxënësve të moshës 15- vjeçare në 65 vende pjesmarrëse dhe është bërë publik dje nga Organizata për Bashkëpunim e Zhvillim Ekonomik (OECD). PISA është vlerësim me besueshmërinë më të lartë dhe me një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e politikave arsimore më mbarë botën.*

faqe 2

### PROJEKTLIGJI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

*Ligji i Arsimit të Standardeve Evropiane!*

*Nga fjala e plotë e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Z. Myqerem Tafaj*

faqe 3-5

*Pamje nga shkolla “Ibrahim Rugova” Kamëz*



## Shqipëria - Progres të dukshëm në arsim sipas raportit “PISA” të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD 2010)

Ministri Arsimit dhe Shkencës zoti Myqerem Tafaj në një konferencë për shtyp uroi 8 Dhjetorin ditën e rinisë, datën historike në përmbushje të 20 vjetorit të lëvizjes studentore që solli përmbysjen e diktaturës. Ministri Tafaj, tha se e veçanta qëndron në faktin se studentët shqiptarë me në krye Azem Hajdarin ishin lider të lëvizjes bashkë me intelektualë të shquar të vendit. Në këtë ditë feste Ministri Arsimit dhe Shkencës, zoti Tafaj, ka përcjellë para medias rezultatet e raportit “PISA 2009”, Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve, të publikuara me 7 Dhjetor 2010. Nga 65 vendet pjesëmarrëse në këtë program, Shqipëria është ndër tre vendet, që ka bërë progres më të madh në arritjet e nxënësve në gjuhë amtare e letërsi, matematikë dhe shkencat natyrore.

Raporti “PISA 2009” (Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve) ka vlerësuar arritjet e nxënësve të moshës 15- vjeçare në 65 vende pjesëmarrëse dhe është bërë publik dje nga Organizata për Bashkëpunim e Zhvillim Ekonomik (OECD). PISA është vlerësim me besueshmërinë më të lartë dhe me një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e politikave arsimore më mbarë botën.

Ministri Tafaj theksoi se vlerësimi PISA ka disa komponentë thelbësorë që synojnë të ofrojnë një vlerësim kompleks, duke pasur në themel të këtij sistemi tre fusha të dijes:

Gjuhë amtare (lexim dhe të shprehur), matematikë dhe lëndët e shkencave natyrore. Vlerësimi “PISA” për vitin 2009 ka pasur në fokus ose si domen kryesor, gjuhën, aftësinë komunikuese dhe mundësitë shprehëse të nxënësve. Është në praktikën e institucionit PISA,- tha ministri Tafaj, që një nga tre lëndët e lartpërmenduar të jetë objektivi themelor i vlerësimit. Por, ky standard nuk anashkalon edhe elementët e dijes së fushave të tjera, pavarësisht se përqëndrohet në një lëndë të veçantë.

Ministri tha se vlerësimi i dytë, pas vitit 2000, i sapopublikuar për të njëjtën fushë kryesore na jep mundësinë të nënvizojmë që:

Së pari: Ne jemi vlerësuar nga PISA 2009 si një ndër tre vendet me rritjen më të madhe në krahasim me rezultatet e mëparshme. Përkatesisht, Shqipëria është vlerësuar më 36 pikë më shumë se në vitin 2000 në fushën kryesore.

Së dyti: Vendi ynë ka ngjitur 5 shkallë në renditjen përfundimtare, në bazë të performancës së arritjeve të nxënësve, të matura nga ky vlerësim, në krahasim me vitin 2000.

Rezultatet e arritura janë inkurajuese për të gjithë mësuesit dhe nxënësit e shkollave tona. Ne jemi të vetëdijshëm që jemi ende nën mesataren e vendeve të OECD, por jemi në rrugë të mbarë të rritjes së cilësisë dhe arritjes së standardeve ndërkombëtare.

Raporti i “PISA 2009” evidenton disa faktorë parësorë që ndikojnë në rezultatet e vlerësimit për të gjitha vendet pjesëmarrëse.

Si faktor themelor, evidentohet statusi dhe përgatitja e mësuesve. Qeveria “Berisha” po bën reforma të thella në këtë drejtim. Dyfishimi i pagave të mësuesve e ka përmirësuar statusin e tyre social dhe e ka bërë profesionin e mësuesisë më të kërkuar. Gjithashtu, MASH në bashkëpunim me BB (Bankën Botërore), ka ndërmarrë një sërë projektesh që mbështesin kualifikimin e vazhduar të mësuesve, rritjen e aftësive dhe kompetencave të tyre, veçanërisht në IT,

didaktikë dhe ato kompetenca sociale.

Ndërkohë ne kemi filluar reformën e studimeve universitare në mësuesi mbështetur në modelin finlandez, vend i cili edhe në PISA 2000 rezultoi shumë i suksesshëm, vendi i dytë në rankim. Dy grupe ekspertësh kanë vizituar Finlandën. Fakultetet e mësuesisë së Universiteteve tona Publike kanë hartuar curriculat e reja të masterit në edukim sipas modelit të Finlandës

Javën që vjen, e viziton këtë vend edhe një grup deputetësh, të Komisionit Parlamentarë të Edukimit dhe Medias për tu njohur me sistemin arsimor, meqenëse shumë elementë të reformave të ndërmarra në sistemin tonë të arsimit parauniversitar, mbështeten në përvojën e Finlandës.

Kurrikula është faktor tjetër madhor që citohet në raport. Reforma e curriculës në arsimin bazë po thellohet, realizohet me ndihmën e ekspertëve të huaj dhe mbështetjen e BB. Ajo synon përafrimin e programeve lëndore me ato të vendeve më të përparura.


Faktor tjetër i rëndësishëm konsiderohet vijimi i arsimit parashkollor. Kjo do të thotë, që ne duhet të ecim me shpejtësi drejt përmbushjes së objektit që çdo fëmijë 5-vjeçar të vijojë kopështin së paku një vit përpara fillimit të arsimit fillor.

Tregues tjetër i dallueshmë është ndryshimi midis zonës urbane dhe asaj rurale. Ky ndryshim vihet re edhe në testet tona kombëtare të Maturës Shtetërore dhe Provimit të Lirimit. Diferenca lidhet para së gjithash me nivelin e kualifikimit të mësuesve.

Vendi ynë, ka marrë pjesë për herë të parë në “PISA” në vitin 2000 dhe është renditur i parafundit, midis vendeve pjesëmarrëse. Në vitet 2001 e 2004, Shqipëria nuk aplikoi për “PISA” e vitit 2003 dhe 2006. Në vitin 2006, MASH aplikoi për vlerësimin e “PISA 2009”. Pas shumë reformash që u ndërmorrën në sistemin tonë arsimor, ne vendosëm të jemi pjesë e këtij programi serioz të vlerësimit të arritjeve të nxënësve.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpreh konsideratën për vlerësimin serioz që ky institucion i bën arritjeve të arsimit të vendeve pjesëmarrëse dhe me këtë rast, arritjeve të vendit tonë.

Gjej rastin të theksoj, se një përmbledhje e rezultateve dhe konkluzioneve të raportit PISA 2009, do t’u dërgohet të gjitha shkollave të vendit dhe MASH, së bashku me agjencitë e saj, do ta analizojë atë në detaje. Ai do të shërbejë si dokument bazë për reformat në sistemin e arsimit parauniversitar. Reformat e ndërmarra në këtë system na bëjnë që të besojmë se “PISA 2012”, do të sjellë një vlerësim më të mirë për arsimin shqiptar.



# PROJEKTLIGJI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

*Ligji i Arsimit të Standardeve Europiane!*

**Fjala e plotë e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Z. Myqerem Tafaj**

Të dashur mësues, nxënës, specialistë të arsimit, të ftuar nga organizatat partnere, Të nderuar rektorë, dekanë, profesorë,

Zonja dhe zotërinj,

Sot jemi mbledhur për një ngjarje shumë të rëndësishme për sistemin e arsimit parauniversitar shqiptar: hapjen e diskutimit publik të projektligjit “Për Arsimin Parauniversitar”.

Ajo që më gëzon është se kjo ndodh vetëm dy ditë pas shpalljes së rezultateve të Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA 2009), ku vendi

ynë u evidentua si një nga tre vendet që ka realizuar progresin më të ndjeshëm krahasuar me rezultatet e arritura në vitin 2000. Kjo është arritje shumë e rëndësishme e nxënësve dhe mësuesve tanë si dhe e agjencive politikëbërëse dhe manaxhuese të sistemit të APU. Për këtë dëshiroj tu falënderoj dhe të shpreh mirënjohje për çdo nxënës dhe mësues që u përfshi në këtë test. Por, siç e theksova edhe në konferencën time të shtypit, për ne objektiv afatgjatë janë STANDARDET e OECD (me saktë MESATARJA e OECD).

Zonja dhe zotërinj,

Ne jemi ende larg saj dhe na duhet shumë shumë punë. Por ajo që është e rëndësishme, ne jemi në rrugë të drejtë dhe optimist që arritjet e nxënësve tanë do ti afrohen gjithnjë e më shumë standardeve të OECD dhe të BE. Shqipëria nuk është një vend i pasur dhe me buxhet të madh të dimensionit të vendeve nordike. Por Shqipëria e ka renditur arsimin në krye të prioritetëve kombëtare dhe, ajo çka është shumë e rëndësishme, familjet shqiptare nuk kursejnë të investojnë për shkollimin cilësor të fëmijëve dhe të të rinjve. Raporti i PISA 2009 sjell dimensione krejt të reja të masës së ndikimit të faktorëve të veçantë në arritjet e nxënësve dhe cilësinë e shkollimit. Ligji ekzistues, “Për sistemin arsimor parauniversitar”, bashkë me amendimet e tij, luajti një rol parësor në ndryshimet rrënjësore që sistemi arsimor parauniversitar shqiptar realizoi për t’iu përshtatur kërkesave thelbësisht të reja që shtroi për arsimin kalimi nga diktatura në demokraci dhe nga ekonomia tejet e centralizuar në ekonominë e tregut të lirë.

Megjithatë, pas një periudhe të funksionimit të këtij Ligji realitete të reja parashtrajnë nevojën e rishikimit tërësor të tij. Prandaj projekti që po shpallim sot për diskutim publik është një LIGJ i RI, i cili duhet:

- të konsolidojë reformat më të rëndësishme të suk-



sesshme të zbatuara në Shqipëri sidomos gjatë viteve të fundit;

- të krijojë mundësinë për zhvillime të ardhshme arsimore me të njëjtin ritëm me vendet e tjera evropiane. Arsimi i standardeve evropiane duhet ti paraprijë Shqipërisë Evropiane. Që këtu rrjedh edhe slogani: Ky p/ligj do të jetë Ligji i Arsimit të Standardeve Evropiane!

Ligji është hartuar me një pjesëmarrje të gjerë të ekspertëve të MASH, agjencive të saj, DAR/ZA në bashkëpunim me një ekspert të huaj. Për hartimin e tij janë studiuar modele dhe ligje analoge të viteve të fundit të disa shteteve me ngjashmëri në të kaluarën politike dhe në vizionin për të ardhmen si legjislacioni arsimor i Sllovenisë, Çekisë, Hungarisë, Sllovakisë, Lituanisë si dhe i disa vendeve perëndimore si Austria e disa Lande të RFGJ-së.

Më lejoni në vijim të përqendrohëm në disa karakteristika thelbësore të projektligjit:

1. Pasqyron qartë standardet e parashikuara në Kushtetutën tonë dhe në konventat ndërkombëtare për sa i takon të drejtës për arsim, barazisë për arsimim për të gjithë pa asnjë lloj diskriminimi, për shkak të origjinës sociale, përkatësisë fetare, kombësisë, gjinisë, ngjyrës, gjendjes shëndetësore ose ndonjë shkak tjetër.

Në këtë kontekst, duhet të theksuar detyrimi që i vë ligji i ri qeverisë për organizimin e mësimin të gjuhës amtare dhe kulturës shqiptare për fëmijët e qytetarëve shqiptarë që jetojnë në vende të ndryshme të botës, në përputhje me standardet që parashikojnë konventat ndërkombëtare ku vendi ynë ka aderuar.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm janë përcaktimet që parashikon ligji për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta për të mënjanuar disfavorizimin e tyre në procesin e të nxënësve për shkak të aftësive fizike të kufizuara.

Ndërkohë ligji konsolidon standardet e ligjit aktual për shkollimin e fëmijëve të pakicave kombëtare.

2. Përputhet tërësisht me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar si dhe dokumentet strategjike të BE për zhvillimin e APU. Në këtë kontekst, ky ligj mund të konsiderohet si ligji i integritimit të APU shqiptar në Hapësirën Evropiane të Arsimit. Pra p/ligji mbështet objektivin që kemi shpallur, sipas të cilit arsimit shqiptar i paraprin Shqipërisë Evropiane.

3. Krijon hapësirë reale për rritje të cilësisë dhe transparencës së politikëbërjes në arsimin parauniversitar.

Në këtë projektligj sanksionohet qartë roli i Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, në të cilin bëjnë pjesë figura të njohura publike për arsimin. P/ligji kërkon që MASH dhe Këshilli i Ministrave të këshillohen me KKAP për çështje themelore të politikave arsimore, si kurrikula, programet mësimore, tekstet, buxheti, rajonizimi i shkollave, kriteret e hapjes së shkollave publike dhe private, politikat e formimit universitar dhe kualifikimit të vazhduar të drejtorëve e mësuesve, mbrojtjen e të dhënave të nxënësve dhe disa aspekte të tjera.

Nga ana tjetër, për zbatimin e Strategjisë dhe Politikave të Arsimit Parauniversitar në nivel Qarku, ngrihet një Këshill Ekspertësh që funksionon pranë Prefektit.

4. Zgjeron më tej politikën tonë konstante të decentralizimit dhe dekoncentrimit në sistemin e APU dhe, në këtë drejtim, ai realizon standarde të përparuara të afërta me ato evropiane. P/ligji parashikon një rritje të theksuar të rolit të Pushtetit Vendor në zhvillimin e APU dhe precizon kompetencat dhe përgjegjësit e njëjësive të qeverisjes vendore (Bashki/komuna) si dhe të Njësisive Arsimore Vendore (DAR/ZA). Përmes këtij ligji fuqizohet roli politikëbërës i MASH dhe delegohen gjithnjë e më shumë përgjegjësitë dhe kompetencat e administrimit në bashki, komuna dhe DAR/ZA.

5. Krijon kornizën ligjore që garanton rritjen e CILËSISË së APU, e cila është deklaruar si objektivi madhor dhe motoja e gjithë sistemit tonë arsimor.

Ku duket kjo:

a) Konsolidon strukturën e sistemit tonë të APU, ku, për herë të parë, p/ligji shprehet për bërjen gati të detyrueshëm të klasës parapërgatitore të arsimit fillor (çdo fëmijë 5-vjeçar duhet të vijojë së paku 1 vit arsim parashkollor përpara regjistrimit në klasën e parë);

b) Vendos standarde të përparuara në formimin universitar të mësuesve të rinj dhe kualifikimin e vazhduar të mësuesve në detyrë (profesion i

rregulluar; master i shkencave në edukim për të tre nivelet e APU sipas modelit të Finlandës, kualifikimi i vazhduar sipas modeleve të përparuara);

P/ligji institucionalizon plotësisht statusin e mësuesit dhe drejtuesit të shkollës në kuptimin e të drejtave, detyrave si dhe procedurave të konkurrimit për emërimin në punë.

c) Sanksionon një strukturë dhe standarde kurrikulare moderne – të mbështetura në përvojën e vendeve më të suksesshme në arsim. Në këtë këndvështrim ligji mbështet tërësisht thellimin e reformës së kurrikulës në arsimin parashkollor, të detyruar dhe atij të mesëm.

d) Institucionalizon reformën e altertektit si garanci për rritjen e cilësisë së teksteve dhe zhvillimit të sektorit privat në fushën e botimeve.

e) Vendos ne standarde evropiane vevlerësimin e shkollës si dhe Vlerësimin i jashtëm të saj përmes: sondazheve (kampionimit) statistikisht të mbështetura gjatë vitit për klasat e ndërmjetme si dhe provimeve përfundimtare kombëtare, Provimit të Lirimit dhe Matura Shtetërore e finalizuar me Diplomë.

f) Parashikon masa konkrete për mbështetjen e nxënësve me prirje të veçanta (talentet). Përveç kurrikulës me zgjedhje që diferencon prirjet dhe interesat e fëmijëve, Ligji shkon më tej dhe e zgjeron detyrimin e shtetit për nxënësit me aspirata të veçanta, duke i shtuar shkollave të ashtuquajtura social-kulturore për muzikën, artet dhe sportet, edhe shkollat për shkencat dhe teknologjinë duke filluar nga cikli i lartë i arsimit bazë. Ky është një hap kah kultivimi i hershëm i nxënësve me prirje të spikatura.

6. Mbështetet në standarde të përparuara dhe fokusohet në menaxhimin mbi bazën e performancës

Ai nxit një zhvendosje të ndjeshme kah parimet dhe praktikatat e menaxhimit që karakterizojnë sistemet arsimore të vendeve të zhvilluara:

- duke vendosur në qendër të drejtimit dhe menax-



limit performancën e institucioneve dhe të individëve të përshkruara me objektiva të matshme;

- duke bërë rezultatet e të nxënësve qëllimin e vetëm të të gjitha veprimtarive të institucioneve dhe punonjësve arsimorë;

- duke e kthyer vlerësimin e institucioneve dhe punonjësve arsimorë në një normë rutinore pune;

- duke e kthyer raportimin periodik të institucioneve dhe punonjësve arsimorë në një normë rutinore pune.

Ligji siguron me këtë mënyrë një hop:

- të transparencës së veprimtarive të institucioneve dhe punonjësve arsimorë të përfituesit e shërbimit arsimor (nxënësit, prindërit, shoqëria civile);

- të krijimit të mekanizmave me anën e të cilave përfituesit e shërbimit arsimor marrin pjesë në realizimin e këtij shërbimi.

7. Projektligji përmirëson dukshëm kuadrin e menaxhimit financiar të APU.

Ai legjitimon modelin e financimit të arsimit parauniversitar publik të mbështetur në formulën “për nxënësit” duke hapur mundësinë e përlllogaritjeve më të sakta mbi bazën e një bashkësie të zgjeruar treguesish. Shtimi i treguesve që merren parasysh gjatë zbatimit të formulës “për nxënësit” do të bëjë të mundur që planifikimi i fondeve në bazë shkollë të jetë më afër specifikave të secilës shkollë. Me këtë mënyrë, duke hedhur hapat drejt autonomisë shkollë, ecet përpara drejt

- transparencës së përdorimit të fondeve financiare;
- shtimit të përgjegjësisë së personelit shkollor në përdorimin e mirë të mjeteve dhe shërbimeve që sigurohen nga këto fonde.

Ligji përfshin për herë të parë në skemën financiare metodën e granteve për shkollat publike me qëllimin për të nxitur zhvillimin e shkollave.

8. Sanksionon për herë të parë dhe sipas praktikave të vendeve të BE, të drejtat dhe detyrimet e nxënësve dhe prindërve si dhe raportet mësues-nxënësit-prind, shkollë-prind. Bashkëpunimi shkollë-prindër zë një vend shumë të rëndësishëm në p/ligj.

9. Për herë të parë Projektligji parashikon mbrojtjen e të dhënave të nxënësve dhe punonjësve arsimorë sipas standardeve të përparuar.

10. Projektligji nxit zhvillimin e arsimit privat cilësor përmes:

- vendosjes së standardeve të njëjta të curriculare dhe të kualifikimit të mësuesve me atë publik
- rritjes së rolit mbikëqyrës të MASH dhe DAR/ZA ndaj politikave të personelit, drejtues dhe mësuesve, në shkollat private

- vlerësimin të jashtëm të cilësisë përmes inspektimit, kampionimit dhe provimeve kombëtare mbështetjes financiare për nxënësit, mësuesit dhe infrastrukturën mësimore për shkollat jofitimprurëse që janë klasifikuar ndër shkollat më të mira të vendit.



Roadmap: çfarë do të ndodhë pas këtij takimi?

Një debat i gjerë nga të gjithë derisa një ligj arsimor është për të gjithë.

Instancat shtetërore, punonjësit arsimorë, në radhë të parë mësuesit, gjithashtu specialistët, organizatat joqeveritare, madje më gjerë prindër dhe përfaqësues të shoqërisë civile në përgjithësi.

Ne kemi dy synime të njehershme kur dëshirojmë dhe do të organizojmë një debat të gjerë e të gjithanshëm; Ta përmirësojmë sa më shumë këtë projektligj dhe të ndërgjegjësojmë sa më mirë grupet e interesit arsimor për filozofinë e këtij ligji dhe arsyet e risive të tij.

Çfarë vjen pas ligjit të miratuar?

Një ligj i arsimit parauniversitar përbën themelin e sistemit arsimor, por ai bëhet funksional sidomos nëpërmjet akteve nënligjore, udhëzimeve e urdhrave, rregulloreve të funksionimit të institucioneve. Një pjesë e tyre do të përmbledhen në një version të ri të Dispozitave Normative. Do të kemi kështu një paketë të plotë të legjislacionit arsimor, në frymën bashkëkohore dhe të mundshme për t'u zbatuar me korrektesë nga të gjitha palët e përfshira në zhvillimet tona arsimore.

Zonja dhe zotërinj,

Ky p/ligj, i kthyer në ligj, do të fillojë të zbatohet në vitin 2011. Ai do të jetë baza e zhvillimit të arsimit tonë drejt standardeve evropiane për ti paraprirë Integritimit të Shqipërisë në BE. Si i tillë, edhe njëherë, dëshiroj të nënvizoj se ky është në fakt ligji i Arsimit Shqiptar të Standardeve Evropiane.

Unë ju ftoj të merrni pjesë gjerësisht në diskutimin e projektit në mënyrë që të plotësohet çdo mangësi dhe ligji ta meritojë plotësisht emrin me të cilin e pagëzuam: Ligji i Arsimit shqiptar të Standardeve Evropiane.

**Faleminderit për vëmendjen.**

# PROJEKTLIGJ

**PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**  
**Në mbështetje të nenit 78, nenit 83, pika 1, dhe nenit 57 të Kushtetutës**  
**së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,**

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:**

## **KREU I**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### ***NENI 1***

##### **QËLLIMI I LIGJIT**

Ky Ligj ka për qëllim të përshkruajë misionin, synimet kryesore të arsimit para-universitar, të rregullojë aspektet e ngritjes, organizimit, drejtimit, financimit, sigurimit të cilësisë së institucioneve të arsimit parauniversitar, si dhe rolit të shtetit e të shoqërisë në funksionimin e arsimit parauniversitar.

#### ***NENI 2***

##### **FUSHA E ZBATIMIT TË KËTIJ LIGJI**

1 Fusha e zbatimit të këtij Ligji është sistemi arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.  
2 Parimet themelore, struktura, organizimi dhe administrimi i arsimit profesional parashikohen në Ligjin Nr. 8872, datë 29.03.2002, “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

#### ***NENI 3***

##### **PËRKUFIZIME**

Në këtë Ligj, termat e mposhtëm kanë këto kuptime: a) “KSNA” do të thotë Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Arsimit, i miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s në sesionin e 29-të të saj në nëntor 1997 (ISCED); b) “Arsimi parauniversitar” përfshin arsimimin në nivelet 0, 1, 2 dhe 3 sipas KSNA. “Niveli 0” përfshin arsimin parashkollor (kopshti); “Niveli 1” përfshin arsimin fillor; “Niveli 2” përfshin arsimin e mesëm të ulët; “Niveli 3” përfshin arsimin e mesëm të lartë. c) “Arsimi bazë” përfshin arsimimin në nivelet 1 dhe 2; d) “Arsimi i mesëm” përfshin arsimimin në nivelet 2 dhe 3; e) “Arsimi i mesëm i lartë” përfshin gjimnazin dhe arsimin profesional; f) “Shkollë” do të thotë institucion që ofron shërbim arsimor për nivelet 1, 2, 3; g) “Institucion arsimor” do të thotë kopsht ose shkollë; h) “Institucion arsimor privat” do të thotë institucion arsimor jopublik; i) “Institucionet në sistemin arsimor parauniversitar” do të thotë Ministria e Arsimit dhe Shkencës, institucionet e saj të varësisë qendrore, njësitë arsimore vendore, kopshtet dhe shkollat; j) “Institucion plotësues” do të thotë institucion publik ose privat, i cili ofron shërbime që pasurojnë përvojën mësimore dhe jetësore të nxënësve; k) “Seksioni dygjuhësh” është model mësimdhënie/nxënie dygjuhësh dhe dykulturore e mbështetur në sistemin europian të Mësimin të Gjuhës të Ndërthurur me Përmbajtjen; i) “Kualifikimi i punonjësit” do të thotë fitimi prej tij i një prej tri shkallëve të cilat përcaktohen në këtë Ligj; j) “Nxënës” është person që arsimohet në nivelet 0, 1, 2, 3; k) “Nxënës me nevoja të veçanta” do të thotë nxënës, i cili, si rezultat i dëmtimeve të ndryshme fizike, mendore, shqisore, të sjelljes ose të kombinuara, mund të pengohet të marrë pjesë në mënyrë të plotë dhe efektive në shkollë dhe në jetën e përbashkët; l) “Punonjës arsimor” do të thotë drejtori dhe nëndrejtori i institucionit arsimor, mësuesi, psikologu dhe mësuesi ndihmës; m) “Mësues” është personi që ka fituar të drejtën të ushtrisë profesionale në nivelet 0, 1, 2, 3; n) “Kompetencat e nxënësve” do të thotë kombinim i njohurive, aftësive dhe

qëndrimeve që nxënësit duhet të zotërojnë në përfundim të një niveli arsimimi;

o) “Korniza kurrikulare” është dokumenti themelor i kurrikulës ku përshkruhen parimet dhe synimet e përgjithshme të saj, aftësitë kryesore që e përshkojnë kurrikulën, fushat e të nxënësve dhe synimet e secilës, parimet themelore të mësimdhënie/nxënies dhe të vlerësimit të nxënësit;

p) “Kurrikula bërthamë” është tërësia e lëndëve të përbashkëta për të gjithë nxënësit e një klase dhe programet përkatëse lëndore; p) “Kurrikula me zgjedhje të detyruar” është tërësia e lëndëve ndër të cilat nxënësi është i detyruar të përzgjedhë një ose disa prej tyre, bashkë me programet lëndore përkatëse;

q) “Program lëndor” do të thotë përshkrim përmbledhës i një lënde që përmban synimin e saj, objektivat e arritjeve të nxënësve, numrin e orëve mësimore dhe metodologjinë specifike të mësimdhënie/nxënies;

r) “Plani mësimor” është dokumenti që përmban listën e lëndëve dhe numrin e orëve mësimore të kurrikulës bërthamë dhe të kurrikulës me zgjedhje; s) “Prind” do të thotë personi që ka të drejtën e përkujdesjes ligjore për fëmijën në bazë të ligjit përkatës.

## ***NENI 4***

**KUADRI RREGULLATOR DHE MBËSHTETËS I SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**  
Sistemi arsimor parauniversitar funksionon: a) Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, legjislacionin shqiptar dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë; b) Sipas traditave më të mira të arsimit kombëtar shqiptar; c) Mbështetur në vlerat e përbashkëta të sistemeve arsimore bashkëkohore europiane e më gjerë dhe të risive e praktikave të tyre të suksesshme.

## ***NENI 5***

**LAICITETI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

1 Arsimi parauniversitar publik ka karakter laik.

2 Në institucionet arsimore është i ndaluar indoktrinimi fetar.

## ***NENI 6***

**E DREJTA PËR ARSIMIM**

1 Arsimiti parauniversitar (më tutje “arsimimi”) në Republikën e Shqipërisë garantohet me kushtetutë për të gjithë shtetasit e saj;

2 Të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë ose shtetasve të huaj që banojnë në Republikën e Shqipërisë, në moshën e përcaktuar nga ky Ligj, brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë, u sigurohet ndjekja e institucioneve arsimore pa asnjë lloj diskriminimi për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, besimit ose përkatësisë fetare, kombësisë, origjinës etnike ose sociale, pronës, përkatësisë farefisnore, gjendjes shëndetësore ose ndonjë status tjetër të qytetarit;

3 Të gjithë fëmijëve dhe të rriturve u sigurohet e drejta e mundësive të barabarta për të ndjekur institucionet arsimore;

4 Procedurat dhe dokumentacioni për regjistrimin e nxënësve në institucionet arsimore përcaktohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës (më tutje “Ministri”).

## ***NENI 7***

**PARIMET KRYESORE TË SË DREJTËS PËR ARSIMIM**

1 Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor.

2 Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me nevoja të veçanta dhe atyre me vështirësi në të nxënë u sigurohet e drejta për përkujdesje të posaçme.

3 Njësitë bazë të qeverisjes vendore dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës (më tutje “Ministria”) krijojnë kushte për sigurimin e nxënësve dhe të punonjësve të arsimit nga dëmtimet fizike, dëmtimet e shëndetit dhe nga rrezikimi i jetës gjatë veprimtarive të tyre në institucionet e sistemit arsimor parauniversitar (më tutje “sistemi arsimor”). Nxënësit, punonjësit e institucioneve arsimore dhe personat që hyjnë në to, e kanë të ndaluar të kenë të fshehur identitetin e tyre fizik.

4 Gjatë veprimtarive në institucionet e sistemit arsimor parauniversitar është e ndaluar çdo formë diskriminimi dhe keqtrajtimi ndaj nxënësve dhe punonjësve arsimorë.

5 Arsimimi publik është falas.

6 Në institucionin arsimor respektohet e drejta e nxënësve dhe e prindërve për t'u informuar mbi veprimtarinë e institucionit.

7 Në institucionin arsimor respektohet e drejta e nxënësve, mësuesve dhe prindërve për të shprehur pikëpamjet mbi vendimet dhe veprimtarinë e institucionit.

8 Në institucionin arsimor respektohet e drejta nxënësve dhe e prindërve që të ngrenë struktura për të mbrojtur të drejtat e tyre, si dhe për të dhënë ndihmesën në mbarëvajtjen e institucionit. Këto struktura ngrihen në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministri.

9 Në institucionet arsimore respektohet e drejta e mbrojtjes së të dhënave vetjake të nxënësve dhe punonjësve arsimorë.

10 Institucionet e sistemit arsimor sigurojnë të drejtën për ankim të nxënësve, prindërve dhe qytetarëve ndaj punonjësve të këtyre institucioneve dhe zgjidhjen e paanshme dhe në kohë të ankesave.

11 Prindërit dhe fëmija i tyre kanë të drejtë të përzgjedhin një institucion arsimor publik ose privat. Nxënësi ka përparësi të regjistrohet në institucionin arsimor publik që i përket ndarjes territoriale të vendbanimit.

12 Nxënësi ka të drejtë të transferohet nga një shkollë në një shkollë tjetër të të njëjtit nivel arsimor, sipas kriterëve e procedurave të transferimit, të përcaktuara me udhëzim të Ministrit.

## ***NENI 8***

### MISIONI I SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

1. Sistemi arsimor parauniversitar synon të kontribuojë në: a) Zhvillimin e plotë dhe të gjithanshëm të individit; b) Përparimin e shoqërisë nëpërmjet aftësisë së qytetarëve për përfshirje aktive në ushtrimin dhe zhvillimin e demokracisë dhe respektimin e shtetit ligjor; c) Mbarëvajtjen e ekonomisë së tregut të lirë nëpërmjet aftësisë së forcave të punës për të përballuar ritmet e rritjes ekonomike dhe të zhvillimit teknologjik.

2. Sistemi arsimor parauniversitar synon që çdo nxënës të:

a) Arrijë zhvillimin e tij etik, intelektual, fizik, social dhe estetik që të jetë i aftë të nxë gjatë të gjithë jetës, të mendojë në mënyrë të pavarur dhe kritike e krijuese, t'u përshtatet ndryshimeve, të ketë vetëbesim e shpirt bashkëpunimi dhe të jetë i gatshëm të ofrojë përpjekjet e tij për mirëqenien, përparimin, lirinë e demokracinë e vendit e më gjerë;

b) Njohë, të respektojë dhe të zbatojë të drejtat themelore dhe liritë e njeriut; c) Përmbushë përgjegjësitë e tij për harmoninë shoqërore dhe ndaj komunitetit të cilit i përket (familja, shkolla ose vendi i punës, shteti dhe më gjerë); ç) Vlerësojë, të ruajë dhe të zhvillojë identitetin kombëtar; d) Mos pajtohet me çfarëdo forme të diskriminimit; e) Respektojë larminë kulturore të popujve të tjerë; dh) Ndërgjegjësohet për të përmbushur përgjegjësitë e tij në mbrojtjen e mjedisit.

## ***NENI 9***

### GJUHA E ARSIMIMIT

Në institucionet arsimore parauniversitare gjuha e arsimimit është gjuha shqipe, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj.

## ***NENI 10***

### GJUHA E ARSIMIMIT PËR PAKICAT KOMBËTARE

1 Personave që u përkasin pakicave kombëtare, u krijohen mundësi të mësojnë në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre brenda kuadrit të planeve dhe programeve mësimore.

2 Për të mundësuar një pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në jetën ekonomike, shoqërore, politike e kulturore të Republikës së Shqipërisë, shteti krijon kushte që personat e pakicave kombëtare të moshës shkollore të mësojnë gjuhën shqipe, historinë dhe kulturën shqiptare.

3 Planet e programet mësimore, si dhe raportet e përdorimit të gjuhës amtare dhe asaj zyrtare në procesin mësimor, përcaktohen me akte të veçanta të Ministrit.

## ***NENI 11***

### **GJUHA E ARSIMIMIT PËR FËMIJËT ME SHTETËSI TË HUAJ**

Në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar, të gjithë fëmijëve të të huajve që banojnë përkohësisht në Republikën e Shqipërisë, u lejohet mësimi në gjuhën e tyre amtare dhe u ofrohet mësimi i gjuhës shqipe.

## ***NENI 12***

### **PROGRAME PËR FËMIJËT SHQIPTARË JASHTË VENDIT**

Në bashkëpunim me përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit dhe struktura të tjera shtetërore, Ministria, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar, organizon dhe mbështet zbatimin e programeve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për personat me kombësi shqiptare që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Programet për fëmijët shqiptarë jashtë vendit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## ***NENI 13***

### **KATEGORIZIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE**

- 1 Në sistemin arsimor funksionojnë: a) Kopshtet; b) Shkollat; c) Institucione plotësuese.
- 2 Institucionet parashkollore, shkollat dhe institucione plotësuese janë publike ose private.

## ***NENI 14***

### **LLOJET E SHKOLLAVE**

- 1 Në sistemin arsimor funksionojnë shkolla me: a) Kohë të plotë; b) Kohë të pjeshme; c) Korrespondencë.
- 2 Një shkollë e arsimit bazë mund të ketë shkolla vartëse. Kriteret e hapjes së shkollave vartëse përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra nga Ministri.
- 3 Ministria krijon kushte për hapjen e shkollave të verës për nxënësit, mësuesit dhe punonjësit e tjerë të sistemit arsimor.

## ***NENI 15***

### **ARSIMIMI NË KUSHTET E SHTËPISË DHE NË INSTITUCIONE JOSHKOLLORE**

- 1 Prindërit kanë të drejtë që fëmija i tyre të arsimohet në kushtet e shtëpisë. Ministri përcakton kushtet e veçanta dhe procedurat për arsimimin në shtëpi për të gjitha klasat e arsimit të detyruar ose për disa prej tyre. Fëmija mund të mësohet nga prindërit dhe/ose nga një person i licencuar që punësohet prej tyre. Vlerësimi i arritjeve të nxënësit kryhet në fund të çdo viti shkollor nga institucioni arsimor ku nxënësi është regjistruar.
- 2 Ministria, në bashkëpunim me institucionet përkatëse të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, siguron arsimimin në institucione penitenciare në institucione sociale dhe në ato mjekësore.

## ***NENI 16***

### **KLASAT E BASHKUARA DHE KLASAT DYGJUHËSHE**

- 1 Në shkollat e arsimit bazë mund të hapen klasa të bashkuara me nxënë të klasave të ndryshme të të njëjtit nivel arsimor. Kriteret e hapjes së klasave të bashkuara përcaktohen nga Ministri me akte nënligjore.
- 2 Klasat e seksioneve dygjuhëshe në gjimnaze krijohen sipas marrëveshjeve dypalëshe midis Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera.

## NENI 17

### INSTITUCIONET PLOTËSUESE

Nxënësit përfitojnë nga institucionet e tjera publike ose private, që ofrojnë shërbime të cilat pasurojnë përvojën mësimore e jetësore të fëmijëve. Institucionet plotësuese publike mund të jenë në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ose të ministrive të tjera. Institucionet plotësuese në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës hapen dhe mbyllen me urdhër të Ministrit.

## KREU II

### NIVELET E ARSIMIT PARAUNIVERITAR

## NENI 18

### ARSIMI PARASHKOLLOR

1 Në përputhje me misionin e sistemit arsimor dhe synimet e tij të përcaktuara në këtë Ligj, arsimi parashkollor synon zhvillimin shoqëror, emocional, intelektual, fizik e gjuhësor të fëmijëve, zotërimin e rregullave themelore të sjelljes dhe formimin e vlerave njerëzore, si dhe parapërgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit fillor.

2 Kopshtet ndiqen nga fëmijët e moshave tre deri në gjashtë vjeç.

3 Shteti inkurajon shtimin progresiv të ndjekjes së arsimit parashkollor, në mënyrë që të pakësojë pabarazitë në zhvillimin e fëmijëve para se të nisin arsimin bazë.

4 Fëmijët e moshës pesë deri në gjashtë vjeç ndjekin klasën përgatitore. Fëmijët e kësaj moshe mund të përfshihen në këtë klasë edhe pa ndjekur më parë arsimin parashkollor. Ministria, në bashkëpunim me njësitë bazë të qeverisjes vendore, përgatit kushtet e nevojshme që të gjithë fëmijët pesëvjeçarë të ndjekin klasën përgatitore.

## NENI 19

### ARSIMI BAZË

1. Në përputhje me misionin e sistemit arsimor dhe synimet e tij të përcaktuara në këtë Ligj, arsimi bazë synon që çdo nxënës të zotërojë aftësitë e të nxënës gjatë gjithë jetës; të formohet me ndjenjat e atdhetarisë; të ketë aftësi të komunikimit dhe të bashkëpunimit; të dijë të përkujdeset për shëndetin e tij mendor dhe fizik, si dhe për mjedisin; të zotërojë njohuritë bazë të gjuhës amtare, të matematikës, të shkencave shoqërore e të natyrës dhe të teknologjisë; të respektojë kulturat dhe traditat e tjera, si dhe të ketë shpirtin sipërmarrës e të parapërgatitet për tregun e punës dhe për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë.

2. Arsimi bazë përfshin arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët. Ai përbëhet nga nëntë klasa, nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Arsimi fillor përbëhet nga gjashtë klasa, nga klasa e parë deri në klasën e gjashtë. Arsimi i mesëm i ulët përbëhet nga tri klasa, nga klasa e shtatë deri në klasën e nëntë.

3. Dëftesa e arsimit bazë është parakusht për ushtrimin e disa profesioneve dhe kryerjen e disa shërbimeve në dobi të qytetarëve.

## NENI 20

### ARSIMI I DETYRUESHËM

1 Të gjithë fëmijët, që mbushin moshën gjashtë vjeç një ditë para fillimit të vitit shkollor dhe që banojnë në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruar të regjistrohen në klasën e parë të arsimit fillor dhe ta ndjekin arsimin bazë deri në klasën e nëntë, me përjashtim të



rasteve të parashikuara në këtë ligj.

2 Nxënësi është i detyruar të ndjekë shkollën me kohë të plotë të arsimit bazë deri sa mbush moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç.

3 Lejohet që nxënësi ta ndjekë arsimin bazë deri në moshën shtatëmbëdhjetë vjeç. Nxënësi, që ka mbushur moshën shtatëmbëdhjetë vjeç dhe nuk ka përfunduar arsimin bazë, lejohet të përfundojë klasën vetëm kur është në klasën e nëntë.

4 Nxënësve, që kanë mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk e kanë përfunduar arsimin bazë, u ofrohet ndjekja e shkollave të arsimit bazë me kohë të pjesshme ose me korrespondencë.

## ***NENI 21***

### **GJIMNAZI**

1 Në përputhje me misionin e sistemit arsimor dhe synimet e tij të përcaktuara në këtë ligj, gjimnazi synon që secili nxënës të zhvillojë më tej nga arsimi bazë njohuritë, aftësitë dhe vlerat e nevojshme për zhvillimin vetjak dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore; të zhvillojë më tej aftësitë e të nxënësve gjatë të gjithë jetës, të thellohet në fusha të veçanta të nxënësve ose lëndë të veçanta, si edhe të ketë parapërgatitjen e mjaftueshme për në tregun e punës ose ndjekjen e arsimit profesional.

2 Nxënësi ndjek arsimin e mesëm të lartë vetëm pasi ka marrë dëftesën e arsimit bazë.

3 Arsimi i mesëm të lartë nuk është i detyrueshëm.

4 Gjimnazi përbëhet nga tri klasa: e dhjetë, e njëmbëdhjetë dhe e dymbëdhjetë.

5 Pranohen në klasën e dhjetë të gjimnazit nxënësit e moshës deri në shtatëmbëdhjetë vjeç dhe ndjekin gjimnazin deri në moshën njëzet vjeç. Nxënësi, që ka mbushur moshën njëzet e një vjeç dhe nuk ka përfunduar gjimnazin, lejohet të vazhdojë klasën që po ndjek deri në fund të atij viti shkollor.

6 Nxënësve, që kanë mbushur moshën njëzet vjeç dhe nuk e kanë përfunduar gjimnazin, u sigurohet ndjekja e gjimnazit me kohë të pjesshme, me korrespondencë dhe nëpërmjet të nxënësve në distancë.

## ***NENI 22***

### **MJETET LEHTËSUESE PËR NDJEKJEN E SHKOLLËS**

1 Sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, në rrethana të veçanta, nxënësve dhe punonjësve të shkollave publike u sigurohet dhe u subvencionohet transporti për në shkollë dhe nga shkolla për në vendbanim.

2 Shteti siguron konvikte për nxënësit e arsimit të mesëm me kohë të plotë, të cilëve nuk u është mundësuar ta ndjekin atë pranë vendbanimit të tyre. Shpenzimet për qëndrimin në konvikt përballohen nga shteti ose/dhe individi, sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

3 Ministria nxit zhvillimin e të nxënësve në distancë për nxënësit, mësuesit dhe punonjësit e tjerë arsimorë.

### **KREU III**

### **DREJTIMI I SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

## ***NENI 23***

### **DREJTIMI I SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

1. Parimet kryesore të drejtimit të institucioneve në sistemin e arsimit parauniversitar janë si më poshtë vijon: a) Zhvillimi i burimeve njerëzore; b) Rritja dhe përdorimi me efektivitet dhe efikasitet të burimeve financiare dhe materiale; c) Transparenca e shërbimit arsimor ndaj përfituesve, përdoruesve të tij dhe më gjerë; ç) Mbështetja e politikëbërjes dhe vendimmarrjes në të dhëna statistikore të përditësuara dhe të besueshme; d) Decentralizimi në nivel vendor dhe autonomia e institucioneve arsimore; dh) Sistemi i mekanizmave të përgjegjshmërisë; e) Përshtatja ndaj ndryshimeve të kërkesave ndaj sistemit arsimor; ë) Bashkëveprimi në mes niveleve qendror, vendor dhe shkollë në përputhje me politika të përbashkëta arsimore; f) Bashkëpunimi me grupet e interesit dhe shoqërinë civile; g) Shkëmbimi i rregullt i përvojave.

1 Sistemi arsimor funksionon sipas: a) standardeve të infrastrukturave, veprimtarive të institucioneve dhe individëve; b) performancës së punonjësve dhe institucioneve; c) treguesve të cilët sigurojnë vëzhgimin

e progresit të institucioneve dhe individëve.

2 Institucionet në sistemin arsimor dhe punonjësit e tyre zhvillojnë veprimtarinë me: a) plane afatmesme dhe vjetore; b) objektiva të matshëm vjetorë; c) vetëvlerësim, vlerësim të jashtëm dhe raportim periodik. Institucionet në sistemin arsimor bashkëpunojnë me grupet e interesit për hartimin e strategjive dhe të planeve dhe për zbatimin e tyre.

## ***NENI 24***

### KËSHILLI I MINISTRAVE

1. Në kryerjen e funksioneve dhe të përgjegjësiive të tij mbi bazën e këtij Ligji, Këshilli i Ministrave:
  - a) Harton politikat e përgjithshme kombëtare arsimore dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
  - b) Miraton Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar;
  - c) Merr vendime në fushën e arsimit, me propozimin e Ministrit.
2. Këshilli i Ministrave përcakton kriteret e përfitimit të subvencioneve, bursave dhe mbështetjeve të tjera ekonomike e materiale për nxënësit nga familje në nevojë dhe për nxënësit me prirje të veçanta.

## ***NENI 25***

### MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

- 1 Ministria ka për mision të zbatojë politikat kombëtare arsimore të hartuara nga Këshilli i Ministrave e vendimet e tij dhe, në përputhje me to, të përmirësojë vazhdimisht cilësinë e shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit.
- 2 Funksionet kryesore të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në arsimin parauniversitar janë si më poshtë vijon:
  - a) Hartimi dhe zbatimi i strategjive kombëtare arsimore;
  - b) Hartimi i projektligjeve për arsimin dhe nxjerrja e akteve nënligjore;
  - c) Planifikimi, hartimi i projektbuxhetit të arsimit dhe zbatimi i tij;
  - d) Vendosja e standardeve kurrikulare, administrative dhe të infrastrukturës;
  - dh) Hartimi i politikave të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë;
  - e) Akreditimi i programeve të trajnimit të vazhdueshëm të punonjësve arsimorë;
  - ë) Vlerësimi kombëtar i arritjeve të nxënësve;
  - f) Inspektimi në sistemin arsimor;
  - g) Auditimi i fondeve dhe i institucioneve në sistemin arsimor;
  - h) Funksionimi i sistemit të menaxhimit të informacionit arsimor;
  - gj) Bashkëpunimi me ministrinë, njësitë e qeverisjes vendore dhe me organizma të tjerë qeveritarë ose joqeveritarë, të vendit ose të huaj.
3. Ministria porositi studime në bashkëpunim me institucione të specializuara të vendit ose të huaja, kërkon mbështetje profesionale vendase ose të huaj dhe bashkëpunon me organizma vendas ose të huaja në hartimin ose/dhe zbatimin e projekteve në fushën e arsimit.
4. Ministria siguron dhe nxit përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie/nxënie dhe në drejtimin e sistemit arsimor.
5. Ministria përcakton për çdo institucion arsimor: a) Datat e fillimit dhe të përfundimit të vitit shkollor, periudhat e pushimeve të nxënësve dhe punonjësve, datat e provimeve të arsimit bazë dhe të maturës shtetërore; b) Vendos për institucionet publike ngarkesën mësimore javore dhe vjetore të mësuesve dhe përcakton numrin më të vogël të nxënësve për klasë; c) Vendos për institucionet arsimore në përgjithësi numrin më të madh të nxënësve për klasë.
6. Ministria publikon raportin e arritjeve të sistemit arsimor parauniversitar për çdo vit shkollor.

## ***NENI 26***

### FUNKSIONI I KËSHILLIT KOMBËTAR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

- 1 Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (më tutje "KKAP") është organ këshillimor i Ministrisë Arsimit dhe Shkencës dhe i Këshillit të Ministrave për politikat e zhvillimit të arsimit parauniversitar.

2 KKAP-i ngrihet me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të KKAP-it.

3 KKAP-i jep këshilla për:

- a) hartimin e strategjive dhe të programeve kombëtare për arsimin parauniversitar, drejtimet e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore;
- b) reformën e kurrikulave dhe të teksteve për arsimin parauniversitar;
- c) projektbuxhetin e parashikuar për arsimin parauniversitar dhe metodologjinë e shpërndarjes së tij;
- ç) standardet për vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar;
- d) zhvillimin e politikave të veçanta, të kërkuara nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe rrugët e financimit të tyre.

4. KKAP-i përbëhet nga 23 anëtarë, si më poshtë: Ministri i Arsimit dhe Shkencës, përfaqësues nga njësitë arsimore vendore, përfaqësues nga ministrinë, përfaqësues i shoqatës së bashkive, përfaqësues i shoqatës së komunave, përfaqësues i shoqatës së këshillave të qarqeve dhe anëtarë të tjerë personalitete të mirënjohura për kontribute të shquara në jetën publike. KKAP-i kryesohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

5. Kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e personaliteteve, në cilësinë e anëtarit të KKAP-it, caktohen me udhëzim të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës dhe bëhen publike. Këta anëtarë përzgjidhen me konkurrim publik nga një komision i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Komisioni përbëhet nga një përfaqësues nga Këshilli i Ministrave, një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe një përfaqësues nga Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional, të caktuar nga vetë këto institucione.

6. Këshilli i Ministrave cakton në detyrën e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar kandidatët e klasifikuar sipas përcaktimit në pikën 5 të këtij neni.

7. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar mbështetet nga një sekretariat teknik, që ndodhet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

8. KKAP-it i paraqet me shkrim Kryeministrit një përmbledhje të këshillave kryesore që i ka dhënë Ministrisë gjatë një periudhe njëvjeçare.

9. PAGESA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT, si dhe përbërja e detyrat e anëtarëve të sekretariatit caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## ***NENI 27***

### MISIONI I NJËSIVE BAZË TË QEVERISJES VENDORE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

1 Njësia bazë e qeverisjes vendore ka për mision të sigurojë kushtet e infrastrukturës së institucioneve arsimore publike dhe të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në territorin nën juridiksionin e saj.

2 Funkcionet kryesore të njësive bazë të qeverisjes vendore në arsimin parauniversitar përcaktohen në Ligjin Nr. 8652, datë 30.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## ***NENI 28***

### FUNKSIONET E QEVERISJES VENDORE PËR INSTITUCIONET ARSIMORE

1. Njësia bazë e qeverisjes vendore mbështet institucionet arsimore me fonde nga buxheti i shtetit ose/dhe nga të ardhurat e saj për: a) shtesën në pagë për punonjës arsimorë; b) ndihmë të posaçme për nxënësit në nevojë; c) shpërblime për nxënësit me prirje të veçanta; ç) trajnimin e punonjësve të institucioneve arsimore;

d) zhvillimin e kurrikulës me zgjedhje.

1 Njësia bazë e qeverisjes vendore, nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e saj, realizon ndërtimet dhe riaftësimin e godinave të institucioneve arsimore publike, sipas standardeve të miratuara nga Ministri.

2 Njësia bazë e qeverisjes vendore garanton paprekshmërinë e institucioneve arsimore, të mjediseve dhe të territorit të tyre.

3 Në buxhetin e shtetit, për njësitë bazë të qeverisjes vendore caktohet një fond minimum “për frymë”

për mirëmbajtjen e çdo institucioni arsimor, në përputhje me standardet e miratuara nga Ministri me akte nënligjore.

6. Njësia bazë e qeverisjes vendore dhe drejtori i institucionit arsimor janë përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e inventarit të institucionit.

## ***NENI 29***

### NJËSITË ARSIMORE VENDORE

1 Ministria përfaqësohet në nivelin vendor nga njësitet vendore arsimore, përkatësisht në nivel qarku me Drejtori Arsimore Rajonale (DAR) dhe në nivel nënprefekturë/rrethi me Zyrë Arsimore (ZA). Këto njësi vendore ngrihen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kryeministri vendos strukturën dhe organikën e njësive vendore arsimore. Ministri emëron dhe liron nga detyra drejtorin e njësisë vendore arsimore sipas procedurave të përcaktuara në akte nënligjore të nxjerra prej tij. Drejtori i njësisë arsimore në nivel prefekturë emëron dhe liron nga detyra përgjegjës të njësisë arsimore në nivel nënprefekturë ose qyteti sipas procedurave të përcaktuara në akte nënligjore.

2 Ministri miraton synimet dhe objektivat e planit afatmesëm dhe atij vjetor të njësisë arsimore vendore si edhe vlerëson punën vjetore të drejtuesit të saj.

3 Njësia arsimore vendore ka për mision organizimin dhe mbështetjen e shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në territorin nën juridiksionin e saj.

## ***NENI 30***

### FUNKSIONET E NJËSISË ARSIMORE VENDORE

Funksionet kryesore të njësisë arsimore vendore janë: a) Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar në nivelin e njësive arsimore vendore përkatëse; b) Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Arsimore në nivel prefekturë; c) Zbatimi i akteve ligjore dhe atyre nënligjore për njësitet arsimore vendore dhe institucionet arsimore; d) Mbështetja e institucioneve arsimore për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor; e) Bashkëpunimi në fushën e arsimit me njësinë bazë përkatëse të qeverisjes vendore.

## ***NENI 31***

### VEPRIMTARI TË NJËSISË ARSIMORE VENDORE

1. Njësia arsimore vendore siguron për institucionet arsimore publike mjetet mësimore.

2. Nga buxheti i shtetit, njësia arsimore vendore realizon pagesën e punonjësve të institucioneve arsimore publike.

3. Drejtuesi i njësisë arsimore vendore miraton synimet dhe objektivat e planit afatmesëm dhe atij vjetor të institucioneve arsimore, vlerëson punën vjetore të drejtorëve të institucioneve arsimore nën juridiksion dhe shpall renditjen e shkollave sipas një bashkësie treguesish të arritjeve, të cilat përcaktohen me udhëzim të Ministrit dhe plotësohen nga njësia arsimore vendore përkatëse sipas politikave të saj.

4. Në bashkëpunim me organizma qeveritare ose joqeveritare, njësia arsimore vendore harton dhe zbaton projekte në dobi të institucioneve arsimore dhe në bashkëpunim me to, si dhe përfshihet në studime ose pilotime me institucione vendase ose të huaja. Ministria njoftohet për projektet e studimit dhe për rezultatet e tyre.

5. Drejtuesi i njësisë arsimore vendore përdor nga buxheti vjetor i saj një shtesë nxitëse vjetore në pagë për drejtuesit e institucioneve arsimore përkatëse për arritje krahasimisht më të larta të institucionit. Kriteret e përdorimit të këtij fondi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Raporti vjetor në nivel qarku i njësisë arsimore vendore i paraqitet Ministrit dhe u bëhet i njohur institucioneve arsimore përkatëse, njësive përkatëse vendore dhe Këshillit Vendor të Arsimit Parauniversitar.

## ***NENI 32***

### KËSHILLI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

1. Këshilli Vendor i Arsimit Parauniversitar (më tutje "KVAP") është organizëm këshillimor që ngrihet me vendim të prefektit të qarkut përkatës dhe kryesohet nga prefekti.
2. KVAP-i këshillon prefektin, drejtuesit e njësive arsimore vendore dhe kryetarin e qarkut përkatës për:
  - a. Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar;
  - b. Hartimin e Strategjisë Vendore të Arsimit;
  - c. Zbatimin e reformave arsimore në nivel qarku; ç. Projektbuxhetin vendor të arsimit;
  - d. Çështje të tjera të vendimmarrjeve arsimore me kërkesën e prefektit, drejtorit të njësisë arsimore vendore ose kryetarit të këshillit të qarkut.
3. KVAP-i përbëhet nga prefekti, kryetari i këshillit të qarkut, drejtuesit e njësive arsimore vendore, përfaqësues të njësive bazë të qeverisjes vendore dhe personalitete të mirënjohura për kontribute të shquara në jetën publike të qarkut.
4. KVAP-i i formulon mendimet dhe propozimet në mbledhjet e tij dhe paraqet me shkrim përmbledhjen e këshillave të tij Ministrisë çdo vit.
5. KVAP-i mbledhet jo më pak se dy herë dhe jo më shumë se katër herë në vit. Anëtarët e KVAP-it të përfitojnë një shpërblim për pjesëmarrje në mbledhje sipas akteve nënligjore në fuqi.

### ***NENI 33***

#### INSTITUCIONI ARSIMOR

- 1 Misioni i institucionit arsimor është krijimi i një mjedisi miqësor ndaj nxënësve dhe sigurimi i mundësive që secili nxënës të shfaqë e të zhvillojë individualitetin e tij. Në përputhje me këtë Ligj, institucioni arsimor pranon dhe mbështet çdo nxënës, pavarësisht nga veçoritë individuale dhe e përfshin atë në mësimdhënie/nxënie.
- 2 Institucioni arsimor siguron mbrojtjen e nxënësve nga çdo formë diskriminimi dhe keqtrajtimi.
- 3 Institucioni arsimor siguron pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e nxënësve, prindërve dhe komunitetit në të gjitha aspektet e veprimtarisë së institucionit, të drejtimit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimit të institucionit.
- 4 Institucioni arsimor njofton nxënësit dhe prindërit e tyre për të drejtat e detyrat e nxënësve dhe për rregullat e institucionit.
- 5 Çdo institucion arsimor ka rregulloren e tij të brendshme, e cila mbështetet në këtë Ligj dhe në akte nënligjore. Rregullorja e brendshme përshkruan rregullat bazë të organizimit, funksionimit dhe drejtimit të institucionit shkollor.

### ***NENI 34***

#### PËRKUJDESJE E POSAÇME E INSTITUCIONIT ARSIMOR NDAJ NXËNËSVE

- 1 Institucioni arsimor organizon veprimtari mësimore plotësuese për nxënësit të cilët hasin vështirësi në arritjen e objektivave minimalë të programit mësimor.
- 2 Institucioni arsimor u siguron nxënësve shërbim psikologjik për mirëqenien mendore, emocionale e fizike të tyre, në përgjithësi, dhe, në veçanti, për shqetësime në të nxënësve dhe në marrëdhëniet me bashkënxënësit, punonjësit e institucionit arsimor dhe prindërit.
- 3 Nxënësit, që për shkak të rrethanave të veçanta nuk mundet të ndjekë përkohësisht shkollën, i sigurohet nga shkolla përkatëse përkujdesje mësimore në shtëpinë e tij. Kuptimi i rrethanave të veçanta dhe procedurat e përkujdesjes përcaktohen me akte nënligjore të Ministrisë.

### ***NENI 35***

#### MOSNDËRPRERJA E VEPRIMTARISË MËSIMORE

- 1 Veprimtaria mësimore nuk mund të ndërpritet nga



asnjë person, përveçse në raste të veçanta, të përcaktuara me akte nënligjore.

2 Kërkime, si testime dhe anketime, zhvillohen në institucionin arsimor vetëm kur nuk cenohet veprimtaria mësimore e nxënësve dhe me lejen e drejtorit të institucionit. Kur përfshihen disa institucione, leja jepet nga drejtuesi i njësisë arsimore vendore përkatëse.

### ***NENI 36***

#### **NDALIME TË DISA VEPRIMTARIVE NË INSTITUCIONIN ARSIMOR**

1 Në institucionet arsimore ndalohet organizimi i veprimtarive partiake dhe/ose fetare me nxënësit ose punonjësit e tyre.

2 Në institucionet arsimore ndalohet indoktrinimi ideologjik i nxënësve.

3 Ndalohet që nxënësit të detyrohen nga punonjësit e institucionit arsimor që të marrin pjesë në veprimtari partiake dhe/ose fetare ose në veprimtari të tjera që nuk janë parashikuar në planin e veprimtarive të institucionit.

4 Ndalohet ekspozimi i simboleve fetare në institucionet arsimore, përveçse në shkollat ku mësohen lëndë fetare.

### ***NENI 37***

B

#### **ORDI I INSTITUCIONIT ARSIMOR**

1. Bordi i institucionit arsimor është organ kolegjal që përfaqëson interesat e nxënësve dhe prindërve të tyre në institucionin arsimor dhe jep ndihmesën në përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të institucionit.

2. Çdo institucion arsimor publik ka një bord të përbërë nga prindër, nxënës, mësues, nga pjesëtarë të komunitetit shkollor, që nuk janë prindër të nxënësve të shkollës, dhe nga të tjerë të përfshirë ose të interesuar në mbarëvajtjen e shkollës. Numri i anëtarëve të bordit si edhe mënyra e funksionimit dhe organizimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit.

3. Bordi i institucionit arsimor publik ka për detyrë edhe të miratojë planin financiar të institucionit, të mbikëqyrë zbatimin e tij dhe të sigurojë fonde financiare për institucionin.

### ***NENI 38***

#### **KËSHILLI PEDAGOGJIK I INSTITUCIONIT ARSIMOR**

Këshilli pedagogjik është organ profesional i institucionit arsimor. Këshilli pedagogjik përbëhet nga mësuesit me kohë të plotë dhe ata me kohë të pjesshme. Veprimtaria e këshillit pedagogjik rregullohet me akte nënligjore të nxjerra nga Ministri.

### ***NENI 39***

#### **EKIPI LËNDOR**

Ekipi lëndor në shkollë ka për synim zhvillimin profesional të anëtarëve të tij. Ekipi lëndor përbëhet nga mësues të shkollës/shkollave të cilët japin mësim në po atë fushë të nxëni ose po atë lëndë. Veprimtaria e ekipit lëndor rregullohet në akte nënligjore të nxjerra nga Ministri.

### ***NENI 40***

#### **ORGANIZIME TË NXËNËSVE**

1. Në shkollë funksionon qeveria e nxënësve, e cila ka për mision: a) të mbrojë të drejtat e nxënësve në shkollë e posaçërisht të punojë për parandalimin dhe eliminimin e çdo forme të keqtrajtimit të nxënësve; b) të japë ndihmesën në plotësimin e nevojave të nxënësve dhe në zhvillimin e interesave të tyre; c) të japë ndihmesën në mbarëvajtjen e shkollës; ç) të përfaqësojë nxënësit e shkollës në bordin e shkollës dhe në organizma të tjerë të shkollës.

2. Organizimi dhe funksionimi i qeverisë së nxënësve rregullohet me akte nënligjore të nxjerra nga Ministri.

3. Në shkollë funksionojnë organizime jopolitike të nxënësve me nismën e tyre, si rrethe shkencore, kulturore ose sociale, sipas interesave të nxënësve.

## KREU IV

### PLANIFIKIMI DHE FINANCIMI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

#### *NENI 41*

##### PLANIFIKIMI I FINANCIMIT NË ARSIMI PARAUNIVERSITAR

1 Burimet për financimin e arsimit parauniversitar janë: a) Buxheti i shtetit; b) Burimet e qeverisjes vendore; c) Dhurimet dhe sponsorizimet; ç) Të ardhurat e përftuara nga shkollat; d) Tarifatat e arsimit për institucionet arsimore private; dh) Të ardhura të tjera nga burime të ligjshme.

2 Ministria harton projektbuxhetin për sistemin arsimor në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, njësitë arsimore vendore dhe institucionet arsimore. Ministri këshillohet me KKAP-in para se ta dërgojë projektbuxhetin në Këshillin e Ministrave.

3 Financimi nga buxheti i shtetit detajohet sipas niveleve arsimore, me formulën “për nxënës” dhe sipas një numri treguesish që diferencojnë kushtet e veçanta të institucioneve arsimore.

4 Ministri përcakton me akte nënligjore mallrat dhe shërbimet, që u takojnë institucioneve arsimore publike dhe njehsohen me formulën “për frymë”.

5 Ministria, në bashkëpunim me njësitë bazë të qeverisjes vendore dhe pas këshillimit me KKAP, racionalizon shpërndarjen e shkollave në mënyrë që të shmangen shkollat me numër të vogël nxënësish. Numri më i vogël i klasave për një shkollë përcaktohet nga Ministri.

6 Për të nxitur plotësimin e shkollave të zonave të largëta ose të thella me punonjës arsimorë, parashikohen shtesa mbi pagën e punonjësve të shkollave publike ose përfitime të tjera sipas kriterëve të vendosura nga Këshilli i Ministrave.

#### *NENI 42*

##### FINANCIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE

1 Institucioni arsimor publik përfiton nga njësi bazë e qeverisjes vendore përkatëse një fond sipas formulës “për nxënës, që e përdor për riparime të vogla ose shpenzime të tjera të nevojshme. Ky fond përdoret sipas kriterëve të vendosura me vendim të Këshillit të Ministrave.

2 Ministria veçon nga buxheti i shtetit një fond (grant shkollor) për të cilin konkurrojnë institucionet arsimore publike dhe që përdoret për të përmirësuar kushtet e të nxënësve. Ministria, pas konsultimeve me KKAP-in, shpall politikën vjetore të grantit, kriteret për përfitimin dhe përdorimin e tij, treguesit e efektivitetit dhe siguron mekanizmat e kontrollit të përdorimit të tij nga institucionet arsimore.

#### *NENI 43*

##### MBËSHTETJA FINANCIARE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITARE PRIVAT

1 Ministria mbështet financiarisht shkollat private vendase të cilat janë institucione jofitimprurëse, kanë të paktën pesë vjet që funksionojnë si institucione arsimore private dhe kanë rezultate të larta në vlerësime kombëtare ose ndërkombëtare. Sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, mbështetja financiare diferencohet sipas renditjes së shkollës për arritjet e nxënësve në provimet e arsimit bazë ose të maturës shtetërore.

2 Shkollat private e përdorin mbështetjen financiare për: a) mjete të laboratorëve mësimorë, pasurim të bibliotekës, trajnime të mësuesve; b) bursa ose/dhe subvencione shtesë të teksteve për nxënësit në nevojë dhe ata me prirje të veçanta, si dhe për shpërblime për nxënësit me prirje të veçanta ose për mbështetjen e tyre për pjesëmarrje në veprimtari të posaçme për ta, si olimpiada, konkurse etj; c) Jo më pak se 50 për qind të fondit mbështetës financiar shkolla private e përdor për pikën 2/b të këtij neni.

#### *NENI 44*

**MBLEDHJA DHE PËRDORIMI I FONDEVE FINACIARE NË INSTITUCIONET ARSIMORE**

1 Institucionet arsimore publike lejohen të sigurojnë nga dhurues ose sponsorizues fonde financiare ose/ dhe mbështetje materiale.

2 Institucionet arsimore publike lejohen të sigurojnë të ardhura nga shërbime për të tretët. Shërbimet kryhen pa cenuar kushtet e të nxënimit. Llojet e shërbimeve për të tretët caktohen nga Këshilli i Ministrave.

3 Fondet e siguruar nga shërbimet ndaj të tretëve në institucionet arsimore arkëtohen në njësinë shpenzuese përkatëse.

4 Institucionet arsimore publike lejohen të përdorin 100% të fondeve të siguruar sipas pikës 1 të këtij neni.

**KREU V****HAPJA DHE MBYLLJA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE*****NENI 45*****HAPJA DHE MBYLLJA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PUBLIKE**

1 Ministri, me propozim të njësisë bazë të qeverisjes vendore, në bashkëpunim me njësinë arsimore vendore dhe pas këshillimit me KKAP-in, vendos për hapjen/mbylljen e një institucioni arsimor publik.

2 Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, hap dhe mbyll institucione arsimore të pakicave kombëtare, institucione arsimore ku zhvillohen edhe lëndë fetare dhe institucione arsimore ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj. Ministri këshillohet me KKAP-in për këto propozime.

***NENI 46*****LICENCIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE**

Licencimi, pezullimi dhe revokimi i institucioneve arsimore private, të cilat nuk përmenden në pikën 2 të nenit 45 të këtij Ligji, kryhet nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL-së), me vendim të Ministrit. Subjekte për licencim si institucione parashkollore private dhe shkolla private janë persona fizikë ose juridikë.

***NENI 47*****KRITERET BAZË TË LICENCIMIT TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE**

1. Për licencimin e institucioneve private të arsimit parauniversitar, QKL-ja, me miratimin e Ministrisë, zbaton kriteret e mëposhtme: a) Objektivat e institucionit dhe kurrikula e hartuar janë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me këtë Ligj dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministri;

b) Mjediset e institucionit janë të sigurta për nxënësit dhe punonjësit e tij, si dhe respektojnë normat e higjienës dhe standardet e ndërtimeve të përcaktuara nga Ministria dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi;

c) Institucioni siguron situatën ligjore dhe financiare të punonjësve të tij në përputhje me këtë Ligj, me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë dhe me aktet nënligjore në fuqi;

ç) Institucioni është i pajisur me mjete të mjaftueshme mësimore, laboratorë dhe pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të përmbushur kërkesat e planit dhe të programeve mësimore;

d) Institucioni garanton se do të respektojë marrëdhëniet kontraktuese me klientët dhe nga ana financiare mbarëvajtjen dhe vazhdimësinë e shërbimit arsimor për së paku dy vite shkollorë. Njehsimi i



shumës së garancisë bëhet duke mbledhur kostot fikse dhe kostot “për nxënës”. Kjo shumë depozitohet e ngrirë për së paku një vit shkollor pranë një banke me vendndodhje në Republikën e Shqipërisë dhe deklarohet para fillimit të çdo viti shkollor.

2. Për shkollat private, në të cilat zhvillohen lëndë fetare ose mësimi bëhet në gjuhën të huaj, kriteret dhe procedurat përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Në këto shkolla, gjuha dhe letërsia shqipe, historia e kombit shqiptar dhe gjeografia e Shqipërisë zhvillohen në gjuhën shqipe.

## ***NENI 48***

### VLEFSHMËRIA E LICENCËS

1 Licenca vlen vetëm për subjektin përgjegjës dhe vetëm për atë nivel arsimor, vendndodhje dhe mjedise, për të cilat është dhënë fillimisht.

2 Çdo ndryshim i bërë nga ana e subjektit të licencuar, i duhet komunikuar QKL-së. Në rast se ndryshimet e bëra kanë të bëjnë me kriteret e licencimit, licenca revokohet dhe kërkesa trajtohet si aplikim të ri.

3 Afati i vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesave për licencim ose për ndryshime përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

## ***NENI 49***

### PEZULLIMI I LICENCËS

1 Ministri pezullon/revokon licencën e institucionit arsimor privat.

2 Një institucion arsimor, licenca e të cilit është pezulluar, mund ta fitojë atë për vitin pasardhës shkollor, në qoftë se plotëson kriteret e licencimit të përshkruara në këtë ligj. Vendimi përfundimtar mbi revokimin e licencës është i pakthyeshëm për subjektin dhe institucioni mbyllet përfundimisht.

3 Në rast të pezullimit dhe revokimit të një licence, njësia arsimore vendore përkatëse i vendos nxënësit në institucione të tjera arsimore publike ose private. Shpenzimet për përfundimin e një viti shkollor për të gjithë nxënësit e regjistruar në atë shkollë private përballohen nga garancia bankare e institucionit arsimor privat të mbyllur.

## **KREU VI**

### **KURRIKULA**

## ***NENI 50***

### TË PËRGJITHSHME

1. Kurrikula merr parasysh fazat e zhvillimit fizik, mendor dhe emocional të nxënësve, si dhe veçoritë e tyre individuale të të nxënësve.

2. Kurrikula mbështetet në kompetencat themelore për të gjithë nxënësit, të cilat janë: a) Komunikimi në gjuhën amtare; b) Komunikimi në gjuhë të huaja; c) Kompetencat bazë në matematikë, shkencat dhe teknologjinë; ç) Kompetencat bazë digjitale; d) Kompetencat për të nxënë gjatë të gjithë jetës; dh) Kompetenca e sipërmarrjes; e) Kompetencat ndërpersonale, ndërkulturore, shoqërore dhe qytetare; ë) Të shprehurit e qartë të ideve, përvojave dhe ndjenjave me anën e formave të ndryshme mediatike, dhe nëpërmjet muzikës, arteve dhe letërsisë.

3. Gjatë hartimit të kurrikulës, u jepet rëndësi parësore aftësive, të tilla si: a) Të menduarit kritik; b) Të menduarit krijues; c) Përpunimit të informacioneve nga burime të ndryshme; ç) Zgjidhjes së situatave problemore nga realiteti; d) Bashkëpunimit në grupe të vogla; e) Qëndrimit etik e social për ngjarjet, sjelljet dhe informacionet.

4. Ministria krijon kushte për të bërë të mundur përvetësimin e gjuhës amtare nga të gjithë nxënësit sipas objektivave të matshëm për çdo nivel arsimor.

5. Kurrikula zbaton parimin e shumëgjuhësisë duke synuar që nxënësit të përvetësojnë dy gjuhë të huaja, njëra prej të cilave njihet si gjuhë e huaj e parë, e cila, në fund të arsimit të mesëm të lartë, të përputhet

me nivelet e përcaktuara në Kuadrin e Përbashkët European të Referencave për Gjuhët.

## ***NENI 51***

### STRUKTURA E KURRIKULËS SHKOLLORE

1 Kurrikula e niveleve arsimore përbëhet nga të njëjtat fusha të nxëni.

2 Zhvillimi i kurrikulës bazohet në standardet e përmbajtjes dhe të arritjeve të nxënësve sipas fushave të të nxënit dhe lëndëve. Pas konsultimit me KKAP, ministri miraton standardet për: a) arsimin parashkollor; b) klasat 1-3; c) klasat 4-6; ç) arsimimin e mesëm të ulët; d) arsimin e mesëm të lartë.

3 Kurrikula shkollore përbëhet nga kurrikula bërthamë dhe ajo me zgjedhje. Si pjesë të kurrikulës me zgjedhje, shkolla harton kurrikulën në bazë shkolle në përputhje me kërkesat e nxënësve dhe të prindërve të tyre. Plani mësimor shkollor përmban edhe veprimtari shkollore jashtëkurrikulare që kanë për qëllim pasurimin e përvojave mësimore dhe jetësore të nxënësve.

4 Ministri, pas këshillimit me KKAP-in, përcakton, sipas niveleve arsimore dhe klasave të tyre, raportin midis kurrikulës bërthamë, kurrikulës me zgjedhje në përgjithësi e të asaj në bazë shkolle dhe veprimtarive shkollore jashtëkurrikulare.

## ***NENI 52***

### DOKUMENTACIONI I KURRIKULËS SHKOLLORE

1 Dokumentacioni i kurrikulës përbëhet nga korniza kurrikulare, standardet e fushave (lëndëve), plani mësimor dhe programet lëndore.

2 Dokumentacioni i kurrikulës hartohet nëpërmjet bashkëpunimit të specialistëve të institucioneve të varësisë qendrore të Ministrisë, mësuesve dhe prindërve, si dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

3 Ministri, pas konsultimit me KKAP, miraton dokumentacionin e kurrikulës, përveç atij që hartohet nga institucioni arsimor. Ministri, për miratimin e dokumentacionit të kurrikulës kur është e nevojshme, ngre komisione me specialistë për fusha të caktuara të nxëni.

4 Një institucion arsimor privat zbaton dokumentacionin e kurrikulës së miratuar me akte nënligjore të Ministrit, ose e përshtat atë, ose harton e zbaton standardet e fushave të të nxënit, planin mësimor e programet e lëndëve sipas politikave të tij dhe në përputhje me te drejtat që përmban ky ligj dhe legjislacioni shqiptar.

## ***NENI 53***

### KURRIKULA E ZBATUAR

1 Kurrikula në nivel institucioni arsimor zbatohet në përputhje me këtë Ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Ministri, sipas synimeve të institucionit arsimor, parapëlqimeve të nxënësve e prindërve të tyre dhe lirisë profesionale të mësuesve.

2 Mësuesi zbaton kurrikulën në mënyrë krijuese dhe duke përzgjedhur ndërmjet praktikave bashkëkohore më të mira vendase e të huaja. Mësuesi e zhvillon mësimdhënie/nxënien mbi bazën e objektivave të programit lëndor dhe objektivave të arritjeve për nxënësit e tij.

## ***NENI 54***

### TEKSTET SHKOLLORE DHE PAKETA KURRIKULARE

1 Në shkolla përdoren vetëm tekste për nxënësit të cilat certifikohen nga Ministria pas shqyrtimit nga komisionet e ekspertëve, mbi bazën e kriterëve shkencore dhe didaktike si edhe standardeve teknike të njëjta të përcaktuara prej saj.

2 Tekstet për nxënësit dhe paketa kurrikulare sigurohen nga subjektet botuese private, vendase ose të huaja, të cilat konkurrojnë në tregun e lirë përkundrejt përzgjedhjes nga mësuesit e shkollës.

3 Tekstet për nxënësit për lëndë dhe klasë në përgjithësi janë alternative.

4 Tekstet për pakicat kombëtare dhe për arsimin profesional sigurohen mbi bazën e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

**KREU VII****VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE*****NENI 55*****VLERËSIMI I BRENDSHËM I NXËNËSVE**

1 Nxënësit e klasave 1-3 vlerësohen me fjalë dhe shprehje. Nxënësit e klasave 4-12 vlerësohen me nota. Notat janë numrat e plotë nga 1 deri më 10, ku nota më e ulët kaluese është 5 (pesa). Rregullat e vlerësimit me fjalë dhe me nota përcaktohen me udhëzim të Ministrit.

2 Nxënësit e klasave 1-3 nuk e përsëritin klasën, me përjashtim të rasteve kur kjo kërkohet nga prindërit e tyre.

3 Rregullat e vlerësimit të brendshëm të nxënësit, të njehsimit të notës vjetore lëndore, të kalimit të klasës, të notës mesatare vjetore, të notës mesatare sipas nivelit arsimor dhe të krediteve përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra nga Ministri.

4 Kur nxënësi është jo-kalues në një ose më shumë lëndë në provimet e arsimit bazë ose të maturës shtetërore, ka të drejtë të hyjë përsëri në provim sipas kushteve të përcaktuara me akt nënligjor të Ministrit.

5 Nxënësi e merr dëftesën e arsimit bazë ose diplomën e gjimnazit kur është kalues në arsimin bazë, përkatësisht në gjimnaz, dhe në të gjitha lëndët e provimit kombëtar të arsimit bazë, përkatësisht të maturës shtetërore.

***NENI 56*****PROVIMET KOMBËTARE**

1. Provimet kombëtare të nxënësve kanë për qëllim të vlerësojnë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar. Këto janë: a) Provimet e arsimit bazë; b) Provimet e maturës shtetërore të gjimnazit; c) Provimet e maturës shtetërore profesionale për shkollat profesionale; ç) Provimet me kampionim.

2. Për zhvillimin e provimeve kombëtare Ministria bashkëpunon me institucionin e varësisë qendrore të vlerësimit kombëtar të arritjeve të nxënësve dhe me njësitë arsimore vendore. Provimet kombëtare zhvillohen sipas Rregullores së Provimeve Kombëtare të miratuar nga Ministri pas këshillimit me KKAP-in.

3. Për provimet kombëtare dhe provimet e korrespondencës institucioni i vlerësimit të arritjeve të nxënësve harton testet lëndore dhe vlerëson përgjigjet e nxënësve. Hartuesit e testeve dhe vlerësuesit e përgjigjeve të nxënësve janë mësues të certifikuar sipas kriterëve të nxjerra me udhëzim të Ministrit.

***NENI 57*****PROVIMET E ARSIMIT BAZË**

Në provimet kombëtare të arsimit bazë, të gjithë nxënësit japin një numër lëndësh të përbashkëta. Këto janë: gjuha shqipe, matematika dhe një lëndë me short.

***NENI 58*****PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE**

Në provimet e maturës shtetërore, nxënësit japin një numër lëndësh të përbashkëta dhe një numër lëndësh me zgjedhje vetjake. Lëndët e përbashkëta për të gjithë nxënësit janë: gjuha shqipe dhe letërsia bërthamë, matematika bërthamë dhe gjuha e huaj e parë. Lista e lëndëve me zgjedhje vendoset me udhëzim të Ministrit.

***NENI 59*****FORMATI I DËFTESËS DHE DIPLOMËS**

1 Ministria përcakton me udhëzim formatin dhe përmbajtjen e dëftesave të klasave 1-8 dhe 10-11, të dëftesës së arsimit bazë dhe të diplomës së maturës shtetërore.

2 Ministria njih të drejtën e një gjimnazi privat për të dhënë një diplomë, e cila është e njohur në një nga vendet e Bashkimit Europian dhe nga agjenci ndërkombëtare të caktuara. Ministri përcakton me udhëzim agjencitë ndërkombëtare dhe procedurat e njehsimit të këtyre diplomave dhe diplomave të shkollës së mesme.

## ***NENI 60***

### **ADMINISTRIMI I PROVIMEVE KOMBËTARE**

1 Administratorët e provimeve kombëtare janë inspektorët dhe mësues nga shkollat që nuk i përkasin njësisë arsimore vendore ku zhvillohet provimi. Mjediset e provimeve miratohen nga agjencia e Ministrisë e cila është përgjegjëse për zhvillimin e provimeve kombëtare.

2 Njësia arsimore vendore menaxhon administrimin e provimeve dhe vlerësimin e përgjigjeve të nxënësve që ndjekin shkollat me korrespondencë.

3. Nxënësit me nevoja të veçanta zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.

## ***NENI 61***

### **PROVIMET ME KAMPIONIM**

Provimet kombëtare me kampionim zhvillohen për lëndë të caktuara:

- a) Nga fundi i klasës së tretë dhe i klasës së gjashtë;
- b) Në klasa të ndërmjetme të arsimit parauniversitar;
- c) Përpara zhvillimit të provimit të arsimit bazë dhe të Maturës Shtetërore.

## ***NENI 62***

### **TESTIMET NDËRKOMBËTARE**

Ministria siguron pjesëmarrjen e Shqipërisë në teste ndërkombëtare. Ministria analizon rezultatet e vlerësimeve kombëtare dhe të testeve ndërkombëtare të nxënësve për rishikimin e strategjive, politikave dhe planeve dhe merr masa mbështetëse për rritjen e cilësisë në shkollat ose zonat me rezultate të ulëta.

## **KREU VIII**

### **INSPEKTIMI**

## ***NENI 63***

### **INSPEKTORATI KOMBËTAR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (IKAP)**

1. Këshilli i Ministrave ngrë një agjenci kombëtare që ka për mision përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në arsimin parauniversitar nëpërmjet inspektimit të institucioneve arsimore dhe njësisve vendore arsimore. Struktura dhe organika e IKAP-it përcaktohen me urdhër të Kryeministrit. IKAP-i ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Udhëzuesin e Inspektimit, të cilin e miraton Ministri.

2. Funkcionet kryesore të IKAP janë: a) Vlerëson cilësinë e shërbimit të institucioneve arsimore dhe të njësisve vendore arsimore; b) Kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve arsimore dhe të njësisve vendore arsimore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; c) Këshillon drejtuesit dhe punonjësit e institucioneve arsimore dhe të njësisve vendore arsimore; ç) Informon Ministrin për gjetjet e tij dhe bën publike raportet e inspektimit.

3. Detyrat, të drejtat dhe funksionimi i IKAP përcaktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave.

## **KREU IX**

### **AUTORITETET DREJTUESE NË INSTITUCIONIN ARSIMOR**

## ***NENI 64***

## DREJTORI I INSTITUCIONIT ARSIMOR

1 Drejtori i një institucioni arsimor është autoriteti drejtues i tij dhe ka për mision të drejtojë veprimtarinë e institucionit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në përputhje me këtë Ligj, me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministri dhe me synimet e institucionit.

2 Funksionin e drejtorit të institucionit arsimor e ushtron personi që ka fituar certifikatën e drejtorit të institucionit përkatës arsimor përmes provimit të kualifikimit që organizohet nga Ministria. Trajnimi i kandidatëve për drejtor zhvillohet nga agjenci trajnuese, programet e të cilave janë akredituar nga një organizëm në varësi të Ministrisë (Komiteti i Akreditimit).

3 Drejtori i një institucioni arsimor ka për detyrë: a) të sigurojë zbatimin në institucion të këtij Ligji, të akteve nënligjore të tij dhe të çdo akti tjetër ligjor ose nënligjor që ka të bëjë me mbarëvajtjen e institucionit;

b) të respektojë standardet e drejtorit të institucionit përkatës arsimor;

c) të drejtojë hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm dhe vjetor të institucionit në bashkëpunim me bordin e shkollës, këshillin pedagogjik, prindër, njësinë arsimore vendore dhe njësinë bazë të qeverisjes vendore, si dhe me pjesëtarë të tjerë të komunitetit;

ç) të sigurojë vlerësimin e herëpashershëm të arritjeve të nxënësve;

d) të drejtojë vetëvlerësimin e herëpashershëm të institucionit arsimor dhe t'u kërkojë punonjësve të institucionit të vetëvlerësojnë rregullisht punën e tyre;

dh) të drejtojë këshillin pedagogjik;

e) të nxitë dhe të sigurojë zhvillimin profesional të punonjësve të institucionit arsimor;

ë) të kryejë vlerësimin vjetor të punës së punonjësve arsimorë të institucionit sipas kriterëve të përcaktuara me akte nënligjore të nxjerra nga Ministri.

4. Drejtori i institucionit arsimor publik përdor një fond vjetor nga buxheti i njësisë vendore arsimore edhe për shtesën në pagë të punonjësve arsimorë të institucionit të cilët kanë arritje krahasimisht të larta. Kriteret e përdorimit të këtij fondi përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

## NENI 65

### NËNDREJTORI I INSTITUCIONIT ARSIMOR

Në përmbushjen e detyrës së tij, drejtori mbështetet nga nëndrejtori. Sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim të Ministrit, një shkollë mund të ketë më shumë se një nëndrejtor. Nëndrejtori ndihmon drejtorin në përmbushjen e detyrave të tij dhe mbështet mësuesit në zhvillimin e tyre profesional. Detyrat e nëndrejtorit përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra nga Ministri.

## NENI 66

### EMËRIMI DHE LIRIMI I DREJTORIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR

1 Drejtori i institucionit arsimor publik përzgjidhet me konkurrim të hapur dhe ka mandat pesëvjeçar të përsëritshëm. Ai emërohet nga drejtori i njësisë arsimore vendore përkatëse pas propozimit të dy kandidatëve të përzgjedhur nga një komision i përbërë nga përfaqësues të grupeve të interesit. Kriteret për drejtor, procedurat e përzgjedhjes dhe të emërimit si dhe përbërja e komisionit përcaktohen nga Ministri me akte nënligjore, pasi merret paraprakisht mendimi i KKAP-it.

2 Drejtuesi i njësisë arsimore vendore përkatëse shqyrton mundësinë e lirit të drejtorit të shkollës publike nga detyra kur:

a) nga pyetësorët e vlerësimit me nxënësit ose prindërit del se ka nivel të lartë të pakënaqësisë nga gjendja në shkollë;

b) arritjet e nxënësve në provimet e arsimit bazë ose të maturës shtetërore për dy vite të njëpasnjëshme



janë në 10% e fundit në renditjen e shkollave në nivel kombëtar;

c) nuk janë përmbushur objektivat e planit vjetor të shkollës për dy vite të njëpasnjëshme

1 Drejtuesi i njësisë arsimore vendore përkatëse liron nga detyra drejtorin e institucionit arsimor publik pa përfunduar mandatin për shkelje në përmbushjen e detyrës. Kuptimi i shkeljeve caktohet me akte nënligjore të nxjerra nga Ministri.

2 Emërimi i drejtorit në institucionin arsimor privat kryhet sipas procedurave të përcaktuara nga vetë institucioni në rregulloren e tij.

## KREU X

### MËSUESI

#### *NENI 67*

#### FORMIMI FILLESTAR

Mësuesi në arsimin parashkollor duhet të ketë fituar diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor” në fushën e edukimit, mësuesi në arsimin fillor dhe në arsimin e mesëm duhet të ketë fituar diplomën “Master i shkencave” në fushën e edukimit ose diplomat e njëvlershme me to.

#### *NENI 68*

#### USHTRIMI I PROFESIONIT TË MËSUESIT

1 Për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të mësuesit, çdo mësues i diplomuar duhet të kryejë praktikën profesionale dhe të kalojë në provimin e shtetit, siç parashikohet në Ligjin Nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2 Me propozimin e institucioneve të shkollave të larta që kanë drejtime studimi në mësuesi si dhe të njësisë arsimore vendore përkatëse, Ministri miraton listën e institucioneve arsimore tutore, të cilat shërbejnë për kryerjen e praktikave mësimore të studentëve të mësuesisë dhe të praktikave profesionale të atyre që janë të diplomuar për mësues.

3 Mësuesi që ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit, regjistrohet në Urdhrin e Mësuesit, i cili ngrihet me ligj të posaçëm.

#### *NENI 69*

#### PUNONJËSIT MËSIMORË PLOTËSUES

Me fondet e siguruara nga dhurimet ose sponsorizimet, drejtori i institucionit arsimor mund të punësojë me kohë të plotë ose të pjesshme mësues ndihmës për klasa të caktuara, për nxënësit me vështirësi në të nxënë ose mësues dhe specialistë për lëndët/modulet me zgjedhje; si edhe mësues jashtë institucionit, që janë të suksesshëm në arritjet e nxënësve, me qëllim që të ndihmojnë në zhvillimin profesional të mësuesve.

#### *NENI 70*

#### TË DREJTAT DHE DETYRAT E MËSUESIT

1. Të drejtat e mësuesit në punë parashikohen në këtë Ligj, në Kodin e Punës dhe në akte nënligjore të nxjerra nga Ministri.

2. Punonjësi arsimor ka për detyrë: a) të respektojë këtë Ligj, aktet e tjera nënligjore, që dalin në bazë dhe në zbatim të këtij Ligji, dhe legjislacionin shqiptar në përgjithësi; b) të respektojë kodin e etikës në marrëdhëniet me nxënësit, kolegët, prindërit dhe eprorët e tij; c) të shmangë dhe të njoftojë konfliktet e mundshme të interesit gjatë kryerjes së detyrës.

3. Mësuesi ka për detyrë: a) të përmbushë objektivat e të nxënësve të çdo nxënësi të tij dhe të zhvillojë mësimdhënie/nxënie me në qendër nxënësin; b) të përmbushë standardet e mësuesit, në përgjithësi, dhe

të lëndës, në veçanti; c) të vetëvlerësohet sipas objektivave të të nxëniet për nxënësit e tij; ç) të përditësojë vazhdimisht aftësitë e tij profesionale; d) të bashkëpunojë me kolegët për zhvillimin profesional; dh) të japë ndihmesën e tij për përparimin e institucionit ku punon.

4. Punonjësi i institucionit arsimor e ka të ndaluar të ushtrojë dhunë fizike ose psikologjike ndaj nxënësve. Mësuesi e ka të ndaluar t'u japë mësim me përfitim financiar ose material nxënësve të institucionit ku është i punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme.

## NENI 71

### ZHVILLIMI I VAZHDESHËM PROFESIONAL I MËSUESIT

1 Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i punonjësve në sistemin arsimor mbështetet në nevojat profesionale të punonjësve dhe institucioneve, si dhe në politikat arsimore qendrore, vendore e institucionale.

2 Llojet e zhvillimit profesional janë: a) Zhvillimi i brendshëm profesional, b) Trajnimet, c) Rrjetet profesionale, ç) Këshillimet, d) Kurset afatshkurtra ose afatgjata.

3 Zhvillimi i brendshëm profesional i mësuesve të një institucioni kryhet nëpërmjet ekipeve lëndore dhe këshillit pedagogjik.

4 Me fondin e buxhetit të shtetit, sipas formulës “për mësues”, njësitë arsimore vendore organizojnë rrjetet profesionale për shkëmbimin e përvojës dhe nxitjen e debatit ndërmjet punonjësve arsimorë homologë.

5 Njësitë arsimore vendore organizojnë këshillime të punonjësve të institucioneve arsimore për problemet që ata hasin në veprimtarinë e tyre të përditshme profesionale.

## NENI 72

### KUALIFIKIMI DHE TRAJNIMI I MËSUESIT

1. Shkallët e njëpasnjëshme të kualifikimit të mësuesve janë tri: a) “mësues i kualifikuar”; b) “mësues specialist”; c) “mësues mjeshtër”.

2. Numri minimal i krediteve për të aplikuar për një shkallë kualifikimi si dhe procedurat e provimit të jashtëm për ta përfituar shkallën e kualifikimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit.

3. Sistemi i trajnimit të punonjësve arsimorë përfshin elementet e mëposhtme: a) Mësuesit, specialistët e njësive arsimore vendore dhe të IKAP-it sigurojnë kredite nëpërmjet trajnimeve nga agjenci të cilave u janë akredituar programet e trajnimit nga Komiteti i Akreditimit; b) Pjesëmarrësit në trajnime marrin certifikatën e një programi trajnimi përmes provimit të jashtëm, i cili zhvillohet sipas procedurave që përcaktohen nga Ministri me akt nënligjor;

c) Trajnimet zhvillohen sipas sistemit “kërkesë-ofertë”: mbi bazën e kërkesave nga institucionet arsimore dhe të ofertave nga agjenci trajnuese.

4. Një shkallë kualifikimi shoqërohet me një shtesë në pagë, masa e së cilës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Burimet financiare për trajnimet e akredituara janë: a) Kontributi vetjak i punonjësit arsimor; b) Buxheti i Ministrisë; c) Projekte të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve, institucioneve vendase ose të huaja.

## NENI 73

### EMËRIMI DHE PUSHIMI NGA PUNA I MËSUESIT

1 Për një vend vakant, mësuesi i diplomuar dhe i licencuar dhe nëndrejtori përzgjidhen me konkurrencë të hapur dhe emërohen nga drejtori i institucionit përkatës, pas propozimit të një komisioni të përbërë nga punonjës të atij institucioni, sipas procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të përcaktuara me udhëzim të Ministrit.

2 Drejtori i institucionit arsimor publik ka të drejtë të largojë nga institucioni një mësues, pas konsultimit me komisionin e përmendur në pikën 1 të këtij neni, kur mësuesi: a) dënohet për vepra penale; b) nuk gëzon shëndet të plotë mendor sipas konfirmimit nga organet e shëndetësisë; c) kryen shkelje të rënda kundrejt nxënësve ose kolegëve, sipas kuptimit të “shkeljes së rëndë” që përcaktohet me udhëzim të Ministrit; ç) nuk arrin të përmbushë detyrimet për kualifikimin e vazhdueshëm; d) ka arritje të ulëta

të nxënësve në krahasim me mësuesit e tjerë të institucionit.

## KREU XI

### NXËNËSIT, PRINDËRIT

#### *NENI 74*

#### NXËNËSIT

- Nxënësi ka të drejtë si më poshtë: a) të regjistrohet në institucionin arsimor publik që është në zonën e përcaktuar nga njësia bazë e qeverisjes vendore përkatëse; b) të arsimohet dhe t'i sigurohen shërbimet e institucionit arsimor sipas moshës, interesave dhe nevojave të veta; c) të informohet për kurrikulën dhe veprimtaritë jashtëkurrikulare që institucioni i ofron; ç) të vihet në dijeni për rezultatet e ndërmjetme dhe përfundimtare të arsimimit të tij; d) të shprehë pikëpamjet e tij mbi çështje të arsimimit të tij dhe të ketë vëmendjen e punonjësve të institucionit arsimor për këto pikëpamje; dh) të zgjidhet në bordin e shkollës, kur mbush moshën katërbëdhjetë vjeç; e) të zgjidhet dhe të zgjedhë në qeverinë e nxënësve dhe në organizata të tjera të nxënësve të shkollës, kur mbush moshën dymbëdhjetë vjeç.
- Nxënësi kanë detyrë: a) të respektojë rregulloren e institucionit; b) të ndjekë mësimet dhe të gjitha veprimtaritë e institucionit të caktuara për të; c) të nxë rregullisht dhe në përputhje me kërkesat e mësuesve dhe të institucionit; ç) të respektojë legjislacionin për mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë në institucion.

#### *NENI 75*

#### PRINDËRIT

- Prindërit janë partneri kryesor i institucionit arsimor për mbarëvajtjen e fëmijës së tyre në institucion dhe për suksesin e institucionit.
- Të drejtat kryesore të prindërve janë: a) të informohen për legjislacionin arsimor në fuqi dhe për rregulloren e institucionit; b) të kërkojnë regjistrimin e fëmijës së tyre në një institucion arsimor që nuk i përket zonës së përcaktuar nga njësia bazë e qeverisjes vendore; c) të informohen nga institucioni arsimor për kurrikulën dhe veprimtaritë jashtëkurrikulare që i ofron fëmijës së tyre; ç) të njoftohen nga institucioni për veprimtarinë e fëmijës së tyre, në veçanti për arritjet mësimore të fëmijës; d) të informohen nga institucioni dhe t'u merret pëlqim për çdo studim, anketim ose veprimtari jashtëshkollore që bëhet me fëmijët e tyre; dh) të vihen në dijeni nga institucioni për objektivat e tij, përmbushjen e tyre dhe renditjen e institucionit në krahasim me institucione të ngjashme; e) të shprehin pikëpamjet për çështje të arsimimit të fëmijës së tyre dhe të kenë vëmendjen e punonjësve të institucionit arsimor për këto pikëpamje; ë) të ankohen për cilësinë e shërbimit të institucionit arsimor kundrejt fëmijës së tyre ose në përgjithësi; f) të zgjidhen dhe të zgjedhin në bordin e shkollës.
- Detyrat kryesore të prindërve janë: a) të kujdesen që fëmija i tyre të ndjekë rregullisht institucionin arsimor dhe të arsyetojnë ose paralajmërojnë çdo mungesë të fëmijës së tyre në veprimtaritë e institucionit arsimor; b) të kujdesen që fëmija i tyre të mësojë rregullisht sipas kërkesave të planit mësimor dhe rregullores së institucionit; c) të njoftojnë mësuesin kujdestar ose/dhe drejtorin për ndryshime të shëndetit që mund të ndikojnë në ecurinë e arsimimit të fëmijës së tyre; ç) të marrin pjesë në takimet që u kërkohen nga drejtori i institucionit ose mësuesi kujdestar për çështje që kanë të bëjnë me fëmijën e tyre; d) të bashkëpunojnë me institucionin arsimor për mbarëvajtjen e institucionit.
- Në institucionet arsimore ushtrojnë veprimtarinë e tyre organizata të prindërve, të cilat përfaqësojnë interesat e tyre dhe japin ndihmesë në mbarëvajtjen e institucionit arsimor. Kriteret e ngritjes dhe ushtrimit



të veprimtarisë së këtyre organizatave përcaktohen me udhëzim të Ministrit.

## KREU XII

### FËMIJËT ME NEVOJA TË VEÇANTA

#### *NENI 76*

#### MISIONI DHE PARIMET E ARSIMIMIT TË FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

1 Në përputhje me misionin e sistemit arsimor parauniversitar dhe me synimet e tij, të përcaktuara në këtë Ligj, arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta synon zhvillimin e plotë të potencialit të individit, ndihmon në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre duke i përgatitur për integrim të plotë në shoqëri dhe në punë.

2 Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore. Ndjekja e institucioneve arsimore të specializuara është përgjithësisht e përkohshme.

3 Në institucionet e arsimit parashkollor dhe atij bazë, kurrikula e hartuar dhe e zbatuar për nxënësit me nevoja të veçanta personalizohet në përshtatje me zhvillimin fizik, mendor, emocional dhe social të nxënësit.

4 Programet e personalizuara për nxënësit me nevoja të veçanta në institucionet arsimore të zakonshme hartohen nga një komision i institucionit i përbërë nga mësues të fushave të ndryshme të të nxënës, nga psikologu dhe nga një specialist i jashtëm për fëmijët me nevoja të veçanta. Për të zbatuar një program të përshtatshëm është e domosdoshme që në konceptimin e tij të përfshihen edhe prindërit.

5 Ministria, në bashkëpunim me njësinë bazë të qeverisjes vendore përkatëse, siguron shkollimin për fëmijët me nevoja të veçanta në njërin nga dy llojet e institucioneve arsimore, të zakonshme ose të specializuara.

#### *NENI 77*

#### KOMISIONI VLERËSIMIT

1 Pranë njësisë arsimore vendore ngrihet Komisioni i Vlerësimit që përbëhet nga mjekë, psikologë, mësues, specialistë për fëmijët me nevoja të veçanta, punonjës socialë. Prindërit kanë të drejtë të marrin pjesë në diskutimet e komisionit për fëmijën e tyre.

2 Komisioni i Vlerësimit përcakton llojin e institucionit parashkollor dhe atë të arsimit bazë që duhet të ndjekë fëmija me nevoja të veçanta, sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministria e Shëndetësisë. Sipas gjykimit të komisionit, fëmija me nevoja të veçanta e nis klasën e parë në moshën gjatë deri nëntë vjeç dhe lejohet të ndjekë arsimin bazë deri në moshën nëntëmbëdhjetë vjeç. Komisioni i Vlerësimit përcakton se cilët fëmijë me nevoja të veçanta përfshihen në detyrimin shkollor dhe cilët regjistrohen me dëshirën e prindërve në institucionet arsimore. Me kërkesën e prindërve, Komisioni vendos që fëmija të nisë arsimin bazë në moshën pesë ose shtatë vjeç.

3 Detyrat e tjera të këtij komisioni përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit

#### *NENI 78*

#### ARSIMIMI I FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

1. Ndjekja e kopshteve/shkollave për fëmijët me nevoja të veçanta rregullohet si më poshtë vijon: a) fëmijët me nevoja të veçanta mësojnë në institucione arsimore të zakonshme, ku nxënësit me nevoja të veçanta bashkohen me nxënësit e tjerë, ose në institucione arsimore të specializuara; b) për fëmijët, që për shkak të aftësive të rënda motorike ose shkaqe të tjera, nuk mund të ndjekin një shkollë të zakonshme ose të specializuar të arsimit bazë, institucioni arsimor, ku ata janë regjistruar, organizon mësim në shtëpi; c) nxënësit me nevoja të veçanta ndjekin arsimin e mesëm të lartë në klasa të zakonshme. Kriteret e ndjekjes së arsimit të mesëm të lartë nga nxënësit me nevoja të veçanta përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, dhe respektimi i tyre ndiqet nga Komisioni i Vlerësimit.

2. Për nxënësit me nevoja arsimore të veçanta, në lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje përdoren: a) programe arsimore të zakonshme; b) programe arsimore të përshtatura ndaj programeve të zakonshme; c) programe arsimore të specializuara.

3. Drejtori i institucionit arsimor të zakonshëm është i detyruar, sipas këtij Ligji, që të pranojë të regjistrojë çdo fëmijë me nevoja të veçanta, në përputhje me përcaktimet e Komisionit të Vlerësimit, dhe të sigurojë kushtet e arsimimit për të, sipas këtij Ligji dhe akteve nënligjore përkatëse të nxjerra nga Ministri.

4. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit në bashkëpunim me prindërit e fëmijës, ndërsa ndryshimi i institucionit arsimor vendoset në bashkëpunim ndërmjet komisioneve të të dy institucioneve arsimore, në këshillim me Komisionin e Vlerësimit dhe në bashkëpunim me prindërit e fëmijës.

5. Shteti siguron falas arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet arsimore publike. Sipas përcaktimit të Komisionit të Vlerësimit, fëmijët me nevoja të veçanta përfitojnë falas transportin nga vendbanimi tek institucioni arsimor dhe anasjelltas. Ministria dhe njësia arsimore vendore pajisin me përparësi nxënësit me nevoja të veçanta me mjetet e përshtatshme të mësimin dhe të nxënies, mjetet e tjera ndihmëse, përfshirë dhe ato të teknologjisë së përditësuar të informacionit dhe komunikimit.

6. Nxënësve me nevoja të veçanta u sigurohen me përparësi punonjësit e mjaftueshëm mësimorë, përfshirë dhe mësuesit ndihmës. Për punonjësit arsimorë, të cilët përkujdesen për fëmijët me nevoja të veçanta, zhvillohen kurse të posaçme në institucionet e shkollave të larta dhe ofrohen trajnime gjatë punës.

## KREU XIII

### NXËNËSIT ME PRIRJE TË VEÇANTA

#### *NENI 79*

#### ARSIMIMI I NXËNËSVE ME PRIRJE TË VEÇANTA

1 Shkollat e nxënësve me prirje të veçanta janë për: a) artet; b) sportet; c) fusha të tjera të të nxënies, si të shkencave, të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit etj. Plani mësimor i shkollave për nxënësit me prirje të veçanta hartohet nga institucioni për zhvillimin e kurrikulës në bashkëpunim me punonjësit arsimorë të këtyre shkollave dhe miratohet nga Ministri. Kriteret dhe procedurat e regjistrimit të nxënësve në shkollat me prirje të veçanta përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra nga Ministri pas këshillimit me KKAP-in.

2 Ministria, njësitë e saj arsimore vendore, njësitë bazë të qeverisjes vendore, shkollat dhe institucionet plotësuese mundësojnë pjesëmarrjen e nxënësve me prirje të veçanta në veprimtari vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ministria dhe njësitë bazë të qeverisjes vendore u akordojnë ndihmë të posaçme financiare dhe materiale nxënësve që kanë prirje të veçanta.

3 Ministri përcakton kriteret për dhënien e medaljeve, certifikatave dhe çmimeve nxënësve me arritje të shkëlqyera në shkollat publike dhe ato private. Për këta nxënës kriteret për dhënien e bursave caktohen nga Këshilli i Ministrave.

## KREU XIV

### MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

#### *NENI 80*

#### MBLEDHJA E TË DHËNAVE PERSONALE TË NXËNËSVE DHE PRINDËRVE TË TYRE

1 Institucioni arsimor mbledh dhe përpunon të dhëna personale të nxënësve dhe prindërve të tyre dhe i vendos ato në dokumentet zyrtare (regjistër, dëftesë, diplomë dhe amzë), si dhe në dosjen personale të nxënësit. Të dhënat personale të nxënësit, që vendosen në këto dokumente zyrtare dhe në dosjen e tij, përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri, pasi merr mendimin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të KKAP-it. Të tilla janë: datëlindja, vendlindja, emrat e prindërve, vendbanimi, ecuria në mësim, sjellja, pjesëmarrja në veprimtari, masat disiplinore.

2 Nxënësit dhe prindërit e tyre janë të detyruar të japin të dhënat e kërkuara në pikën 1 të këtij neni. Nxënësit dhe prindërit e tyre njoftohen paraprakisht për këtë detyrim ligjor. Të dhëna të tjera personale mblidhen vetëm me vullnetin e nxënësve mbi moshën katërbëdhjetë vjeç, përndryshe vendimi merret nga prindërit e tyre. Të dhëna personale për kombësinë, përkatësinë fetare dhe gjendjen shëndetësore mund të mblidhen vetëm për studime dhe pa zbuluar identitetin e nxënësit.

## ***NENI 81***

### **MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE TË NXËNËSVE DHE PRINDËRVE TË TYRE**

1 Të dhënat personale të një nxënësi të veçantë nuk u vihen në dispozicion personave të tjerë jashtë institucionit përkatës, gjithashtu nuk u vihen në dispozicion personave të tjerë nga marrësit e tyre në institucionet e tjera.

2 Rezultatet e nxënësve në provimet kombëtare dhe të dhënat për hyrjen në institucionet e shkollave të larta jepen në mënyrë që të mos zbulohet identiteti i nxënësit.

3 Të dhënat personale të nxënësit bëhen publike vetëm nga vetë nxënësi me moshë mbi tetëmbëdhjetë vjeç, përndryshe vendimi merret nga prindërit e tij.

4 Punonjësi i institucionit arsimor e ka të ndaluar që të japë të dhëna në mënyrë publike ose një personi të veçantë për arritjet mësimore dhe sjelljen e një nxënësi.

5 Nxënësit dhe prindërit e tyre kanë të drejtë të njihen me të dhënat e tyre personale, si edhe të vihen në dijeni për personat që i kanë këto të dhëna.

6 Intervista me një ose me disa nxënës, anketat dhe regjistrimet audio-vizive me ta, zhvillohen vetëm me pëlqimin e nxënësve dhe të prindërve të tyre.

7 Nuk lejohet të publikohen ose t'u vihen në dispozicion të tjerëve rezultatet e nxënësve të veçantë në testimet, anketat dhe përmbajtja e intervistave dhe e regjistrimeve, përveçse me emër të koduar. Nxënësit dhe prindërit e tyre vihen paraprakisht në dijeni për qëllimin e intervistës ose regjistrimit, e kanë pranuar atë dhe më pas e disponojnë.

## ***NENI 82***

### **ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE PERSONALE TË NXËNËSVE DHE PRINDËRVE TË TYRE**

1. Punonjësit e institucionit arsimor, që janë ngarkuar të mbajnë, të përpunojnë, të administrojnë dhe të arkivojnë të dhënat personale të nxënësve, kanë të drejtë t'ua vënë në dispozicion vetëm atyre punonjësve të institucionit, të cilëve këto të dhëna u shërbejnë për të përmbushur detyrat e tyre sipas përcaktimit nga drejtori i institucionit.

2. Të dhënat personale të një grupi nxënësish u vihen në dispozicion të: a) punonjësve të njësisë arsimore vendore përkatëse, vetëm kur janë ngarkuar me shkrim nga drejtuesi saj; b) inspektorëve të Inspektoratit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar dhe punonjësve të Ministrisë, kur janë ngarkuar me shkrim nga një drejtor i tyre. Këto të dhëna nuk identifikojnë nxënësin e veçantë.

3. Të dhënat personale të një grupi nxënësish përdoren për kërkime shkencore nga organizma qeveritarë ose joqeveritarë, pas miratimit të prindërve dhe të drejtorit të institucionit. Këto të dhëna nuk zbulojnë identitetin e nxënësit.

## ***NENI 83***

### **MBLEDHJA E TË DHËNAVE PERSONALE TË PUNONJËSVE**

1. Institucionet e sistemit arsimor mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale të punonjësve të tyre.

2. Punonjësi i institucionit të sistemit arsimor plotëson rregullisht portofolin e tij profesional. Lloji i të dhënave personale të punonjësve dhe përmbajtja e portofolit profesional përcaktohen me udhëzim të Ministrit. Punonjësit janë të detyruar të japin të dhënat personale të përcaktuara me udhëzim të Ministrit. Ata njoftohen paraprakisht për këtë detyrim ligjor.

3. Të dhëna të tjera personale mblidhen vetëm me vullnetin e punonjësve. Të dhëna personale për kombësinë, përkatësinë fetare dhe gjendjen shëndetësore mblidhen vetëm për studime dhe pa zbuluar identitetin e punonjësit.

## ***NENI 84***

### **MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE TË PUNONJËSVE**

1 Intervista, anketa me një ose disa punonjës, si dhe regjistrimet audio-vizive me ta, zhvillohen vetëm me pëlqimin e tyre. Nuk lejohet të publikohen ose t'u vihen në dispozicion të tjerëve rezultatet individuale të testeve, anketa dhe përmbajtja e intervistave dhe e regjistrimeve, përveçse kur emri është i koduar. Punonjësit janë informuar për qëllimin e intervistave ose regjistrimit dhe e kanë pranuar atë.

2 Të dhënat personale të një punonjësi nuk u vihen në dispozicion personave të tjerë jashtë institucionit, gjithashtu nuk u vihen në dispozicion personave të tjerë nga marrësit e tyre jashtë institucionit. Rezultatet e punonjësve në provimet për kualifikim nuk publikohen për punonjës të veçantë. Të dhëna të tjera personale mbledhen vetëm me vullnetin e punonjësve. Të dhënat personale të punonjësit bëhen publike vetëm nga vetë personi.

## ***NENI 85***

### **ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE PERSONALE TË PUNONJËSVE**

1 Punonjësit e institucionit të sistemit arsimor, që janë ngarkuar të mbajnë, të përpunojnë, të administrojnë dhe të arkivojnë të dhënat personale të punonjësve, kanë të drejtë t'ua vënë ato në dispozicion brenda institucionit vetëm atyre punonjësve, të cilëve këto të dhëna u shërbejnë për të përmbushur detyrat e tyre.

2 Të dhënat personale të një grupi punonjësish mund t'u vihen në dispozicion institucioneve të tjera qeveritare ose joqeveritare për kërkime shkencore që synojnë përmirësimin e shërbimit arsimor, çështje ligjore ose sociale, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me miratim të njësisë arsimore vendore.

## **KREU XVI**

### **KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE**

## ***NENI 86***

### **MUNGESAT**

Mungesa e nxënësit në mësim në moshën e arsimit të detyrueshëm për më shumë se 25 për qind të orëve mësimore gjithsej gjatë një viti shkollor, që nuk arsyetohen nga prindi i tij, vlerësohet si rast i neglizhencës prindërore dhe trajtohet në përputhje me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

## ***NENI 87***

### **PUNËSIMI**

Ndalohet punësimi i fëmijëve që përfshihen në detyrimin shkollor. Kur vërtetohen raste të punësimit të fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor, punëdhënësi shtetëror ose privat dënohet për kundërvajtje administrative nga inspektori i punës me gjobë 100 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje, me gjobë 200 000 lekë. Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim dhe protestë, brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit, në gjykatën e qarkut ku është kryer kundërvajtja.

## ***NENI 88***

### **HAPJA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN**

1 Hapja e institucioneve arsimore private dhe e institucioneve arsimore private plotësuese në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në dispozitat e këtij Ligji përbën kundërvajtje administrative. Kundërvajtësit në çdo rast dënohen me gjobë, përkatësisht 500 000 lekë dhe 200 000 lekë deri me ndërprerje të veprimtarisë së filluar.

2 Propozimi për gjobë ose ndërprerje të veprimtarisë bëhet nga IKAP-i dhe vendimi merret nga Min-

istri i Arsimit dhe Shkencës për institucionet arsimore private laike dhe nga Këshilli i Ministrave për institucionet arsimore private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare ose në të cilat mësimi bëhet edhe në gjuhë të huaj.

3 Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit, në gjykatën e Tiranës.

## ***NENI 89***

### **SHKELJET NGA PUNËDHËNËSIT**

IKAP-i, kur konstaton shkelje nga punonjësit e institucioneve arsimore ose njësitë arsimore vendore, të dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore që lidhen me funksionet e tij, ka të drejtë: a) t'u propozojë punëdhënësve masa ndëshkuese për punonjës arsimorë nga "vërejtje" deri në "lirim nga detyra"; b) të gjobisë punonjësit me gjobë në masën nga 10 000 deri në 50 000 lekë.

## ***NENI 90***

### **GJOBAT**

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimi i vendimeve të dënimit me gjobë bëhet sipas dispozitave të caktuara në Ligjin Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

### **DISPOZITAT E FUNDIT**

## ***NENI 91***

Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, nxjerr akte nënligjore në fushën e arsimit dhe, për zbatimin e tyre, ngarkon atë ose ministri të tjera, sipas rastit.

## ***Neni 92***

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka të drejtë të miratojë rregullore, udhëzime e urdhra për zbatimin e këtij Ligji.

## ***NENI 93***

1 Ligji Nr. 7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar" i ndryshuar, si edhe çdo dispozitë tjetër që lidhet me arsimin parauniversitar dhe është në kundërshtim me këtë Ligj, shfuqizohen.

2 Struktura e re e arsimit bazë fillon të zbatohet në vitin shkollor 2014-2015. Të gjitha klasat e arsimit fillor (I-V) që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të vazhdojnë procesin mësimor sipas planeve të mëparshme mësimore.

3 Personeli mësimdhënës, i punësuar me kontratë të përhershme, ruan vendet e punës dhe u nënshtrohet trajnimeve për përditësimin e njohurive shkencore dhe pedagogjike.

4 Institucionet arsimore private dhe institucionet arsimore private plotësuese të licencuara përpara hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009 "Për lejet, licencat dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë", dhe ato të licencuara me ligjin e sipërpërmendur, u nënshtrohen të gjitha dispozitave të këtij Ligji.

## ***NENI 94***

Ky Ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me Dekretin Nr. \_\_, datë \_\_.\_\_.20\_\_



Ju ftojmë të merrni  
pjesë në diskutimin  
e projektligjit

## **“Për sistemin Arsimor Parauniversitar”**

Dërgoni sugjerimet tuaja  
në adresën elektronike:  
**[parauniversitar@mash.gov.al](mailto:parauniversitar@mash.gov.al)**

si dhe me postë  
në adresën e mëposhtme

Adresa e redaksisë: Rruga e Durrësit (pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës), nr. 23 - Tiranë  
tel. 04 2227206 - [revistamesuesi@mash.gov.al](mailto:revistamesuesi@mash.gov.al)

U shtyp në shtypshkronjën “ALBDESIGN” - Autostrada Tiranë-Durrës km. 5 - [www.alb-design.net](http://www.alb-design.net)